

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6003
E martë, 18 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi: FSK-ja, pasqyra
më e mirë e shoqërisë
sonë të lirë dhe
demokratike | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E
KOSOVËS KA
SHËNUAR
12-VJETORIN E
SHPALLJES SË
PAVARËSISË

FAQE 4-5

KOSOVA FESTON 12-VJETORIN E SHTETËSISË, NË PRITJE TË SFIDAVE TË REJA



Republika e Kosovës ka festuar 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë. Për nder të 12- vjetorit të shpalljes së pavarësisë liderët shtetërorë kanë uruar qytetarët e Kosovës duke përmendur të arriturat e shtetit më të ri në Evropë dhe sfidat

që e presin atë. Për ditën më të veçantë në historinë e Kosovës, institucionet qendrore dhe lokale kanë organizuar aktivitete të ndryshme, ndërsa qytetarët kanë festuar nëpër të gjitha qytetet e Kosovës. Edhe këtë vit liderët

politikë kanë bërë homazhe te Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te varri i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi

OPINION

POLITIKA SERBE E
KRYQËZUAR MIDIS KISHËS
DHE AKADEMISË | F. 11

Prof. Lisen
BASHKURTI



AKTUALE

QYTETARËT MBESIN
TË LIDHUR NGUSHTË ME
FLAMURIN KUQ E ZI | F. 7

"NEWBORN"-I ME PAMJE TË RE
| F. 7

NAIM FETAHU, KANDIDAT
I PDK-SË PËR KRYETAR TË
PODUJEVËS | F. 10

EKONOMI



PËR 12 VJET SHTET, KOSOVA
NUK PATI RRIJTE
TË NEVOJSHME EKONOMIKE | F. 8-9

KULTURË

POEZI NGA EMINE MALIQI-ZAIRI
| F. 15

TI MBRËTËRESHA E KËNGËS
SHQIPE | F. 15

Ajet SHALA "AJHASHA"

Histeria e Putinit kundër Perëndimit dhe Kosova si antitezë (1)

Kur jemi në prag të festimit të dymbëdhjetëvjetorit të pavarësisë do të mund t'i kujtojmë dy ngjarje fatale për Kosovën si pasojë e putinizmit. Së pari, vendimin rus për ta kundërshtuar në Këshillin e Sigurimit të

OKB-së intervenimin humanitar të NATO-s më 1999... së dyti, bllokada ruse me kërcënimin për përdorim të vetos në KS të OKB-së më 2007, nëse propozimi për pavarësi të Kosovës do të vihej në tavolinë | FAQE 3

Shkruan:
Enver
HOXHAJ



Shqipëria siguron qindra miliona euro në Konferencën e Donatorëve për dëmet nga tërmeti | FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta akuzon mazhorancën për veprime arbitrare

TRIANË, 17 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, publikoi të hënën dokumente të reja drejtuar SPAK-ut për të thëlluar hetimet mbi ato, që ai i quajti "veprimtaria kriminale e kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Ardian Dvorani, gjatë detyrës së tij".

Këto dokumente Meta ia shtoi kallëzimit penal të nëntorit, ku Dvorani akuzohet për shkelje që shkaktuan mosplotësimin e kuorumit të Gjykatës Kushtetuese, ndaj i "duhet ndaluar menjëherë shpërdorimi i funksionit pub-

lik, përmes të cilit ai synon kapjen politike të Gjykatës Kushtetuese".

Presidenti Meta tha në një deklaratë për mediet se "vendin e fundit vakant në Gjykatën Kushtetuese Dvorani po përpiqet ta zërë vetë përmes vonimit të procesit të plotësimit të kësaj Gjykate, keqinformimeve dhe shkeljeve në krye të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi".

Presidenti Meta tha se parlamenti nga një anë ftoi Komisionin e Venecias të interpretonte mbi betimin e gjyqtarëve kushtetues, por një

ditë para se delegacioni i tyre të mbërrinte në Tiranë parlamentit e ndryshoi vetë atë nen të ligjit mbi betimin e gjyqtarit kushtetues, pa pritur përgjigjen nga Komisioni i Venecias. "Ky ligj synon vendosjen e këtij procesi nën kontroll politik të Partisë Socialiste dhe të nxijë integritetin e çdo anëtari të ri të Gjykatës Kushtetuese, duke i dhënë mesazhin se çdo emërim në këtë Gjykatë do të kalojë përmes testit të besnikërisë politike", tha ai.

Meta theksoi se do të shkonte vetë në Komisionin e Venecias për t'u shpjeguar ato që po



ndodhnin në Tiranë me institucionet dhe reformën në drejtësi. "Republika e Shqipërisë po përjeton gjendjen më të rëndë të kapjes së shtetit në kontinent, por nuk do të pranohet instalimin

e grushtit të shtetit, përmes shndërrimit të institucionit më të rëndësishëm të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, në një polici antikushtetuese të shtetit të PPP-së", tha Meta.

Borrelli nis konsultimet për emërimin e përfaqësuesit në dialogun Kosovë - Serbi

Shefi i diplomacisë evropiane Josep Borrelli pritet që në takimin e radhës, mundësisht në muajin mars, ta bëjë publik propozimin konkret me emrin e personit, të cilit do t'i besohet kjo detyrë, që me gjasë do të jetë ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak



BRUKSEL, 17 SHKURT - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka paralajmëruar se do t'i nisë konsultimet me ministrat e vendeve anëtare rreth emërimit të një përfaqësuesi të posaçëm, i cili do të ketë detyrë lehtësimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Nga burimet diplomatike të "Radios Evropa e Lirë" mësohet se Borrelli ka paralajmëruar të hënën planet që ka për takimin e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të BE-së në Bruksel. Ideja e tij është që në takimin e radhës, mundësisht në muajin mars, të bëhet publik propozimi konkret me emrin e personit të cilit do t'i besohet kjo detyrë.

Edhe pse ende nuk konfirmojnë emra, burimet diplomatike thonë se ai do të jetë ministri aktual i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak.

Borrelli dhe Lajçaku kanë zhvilluar të hënën një takim bilateral në Bruksel në margjinat e takimit të Këshillit. Një ditë më parë, Borrelli ka dhënë sinjale se dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të nisë shpejt.

Në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë", Borrelli thotë se tani Kosova ka qeveri të re dhe se pret që dialogu të nisë. "Qeveria e Kosovës është formuar një javë më parë. Kosovarët nuk kanë pasur qeveri dhe nuk kanë mundur që t'i nisin bisedimet, por tani kanë qeveri", ka thënë Borrelli. Dialogu në mes të Kosovës dhe

Serbisë është pezulluar pas taksës së vënë nga autoritetet e Kosovës në mallrat serbe në

nëntor të vitit 2018.

Dialogu për normalizim të marrëdhënieve në mes të këtyre

dy vendeve ka nisur më 2011 me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian në Bruksel.

Ministri rus i Mbrojtjes viziton Serbinë

BEOGRAD, 17 SHKURT - Serbia dëshiron një ushtri të fortë sepse ajo garanton stabilitetin dhe neutralitetin, por edhe përparimin e vendit, tha ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, gjatë një takimi me homologun e tij rus, Sergei Shoigu, të hënën në Beograd.

Në deklaratën e Ministrisë serbe të Mbrojtjes, Vulin, mes tjerash citohet të ketë thënë se, "formimi i ushtrisë së Kosovës dhe armatosja e saj janë të

papranueshme".

Siç raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë, Vulin dhe Shoigu janë përqendruar në bashkëpunimin e vendeve të tyre në mbrojtje dhe në forcimin e lidhjeve në të ardhmen.

Ministri rus tha se stërvitjet e përbashkëta të të dyja ushtrive janë treguesi më i mirë i marrëdhënieve të ngushta.

Vulini e falënderoi Federatën Ruse për ndihmën ushtarake

dhe teknike që i ofron Ushtrisë së Serbisë. "Vetëm në vitin 2019 janë realizuar 94 aktivitete në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar me Federatën Ruse. Bashkëpunimi në mbrojtje zhvillohet në përputhje me Deklaratën e partneritetit strategjik", tha Ministria e Mbrojtjes në Beograd.

Shoigu gjatë vizitës së tij në Serbi do ta takojë edhe presidentin e këtij vendi, Aleksandar Vuçiq.



Në muajin nëntor të vitit të kaluar, Departamenti amerikan i Mbrojtjes ka nxjerrë një dokument, në të cilin

është thënë se marrëdhëniet Serbi-Rusi janë forcuar që nga ardhja në pushtet e Vuçiqit në vitin 2012.

Histeria e Putinit kundër Perëndimit dhe Kosova si antitezë (1)

Kur jemi në prag të festimit të dymbëdhjetëvjetorit të pavarësisë do të mund t'i kujtojmë dy ngjarje fatale për Kosovën si pasojë e putinizmit. Së pari, vendimin rus për ta kundërshtuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së intervenimin humanitar të NATO-s më 1999... së dyti, bllokada ruse me kërcënimin për përdorim të vetos në KS të OKB-së me 2007, nëse propozimi për pavarësi të Kosovës do të vihej në tavolinë

Shkruan:
Enver HOXHAJ

Përshtypja e parë

Ishte ulur në zyrë. Si këshilltar i presidentit Boris Yeltsin, Putini po e siguronte mysafirin në mirëbesim se "bashkëpunimi ushtarak është 100 %". Përballë tij ishte Strobe Talbott, nënsekretari amerikan i shtetit dhe njohës i rrallë i Rusisë. Posti shtetëror, afërsia me presidentin Clinton, të cilin e kishte njohur në Oksford, kur Talbott po studioonte letërsinë ruse dhe ekspertiza në politikën e jashtme, e favorizonin atë shumë në bisedë. Mirëpo, gjërat nuk ecën mirë mes delegacionit amerikan dhe atij rus. Në takim mes palës ruse u shpërfaqën dallime të mëdha. Ushtarakët kërkonin diçka tjetër, e diplomatët pretendonin tërësisht të kundërtën. Por, gjithçka rrodhi ndryshe dhe zhvillimet morën kthesë pozitive kur në takim u shfaq Putini, këshilltari i lartë për siguri i Jeltsinit. Putini, jo fort i njohur deri atë kohë, ishte më i qartë dhe urban sesa bashkëkombësit e tij. Madje, ai e dha një premtime të fortë para kolegëve nga Uashingtoni, se "qëndrimi rus do të publikohej para se amerikanët të arrinin në aeroport".

"Kjo qe përshtypja ime e parë për Putinin. Paradite na siguroi se deklarata zyrtare do të bëhej dhe se rusët s'do të hyjnë assesi në Kosovë. Ende po pres deklaraten ...", deklaronte Talbott në qershorin e 1999-s. Amerikanët u kthyen duarthatë në shtëpi nga Moska. Brenda pak kohe, një dramë tjetër po zhvillohej në Aeroportin e Prishtinës. Një kontingjent i ushtarëve rusë nga Bosnja e Hercegovina marshoi përmes Serbisë drejt Kosovës, duke marrë nën kontroll ushtarak aeroportin në Sllatinë. Pak ditë më herët, treshja diplomatike - Talbotti, Martti Ahtisaari dhe Viktor Chernomyrdin - i kishte propozuar



Millosheviqit planin për Rezolutën 1244. Diskutimi kishte qenë i gjatë mes tre diplomatëve dhe me diktatorin se si mund të bëheshin forcat ruse pjesë e misionit paqësor të OKB-së në Kosovë. Qëndrimi rus ishte se "ne nuk duhet ta pyesim NATO-n për kurrfarë leje. Është e drejta jonë të veprojmë. Nëse NATO-ja synon t'i vendosë rreth 50.000 njerëz në Kosove, ne do t'i sjellim 10.000."

Moska kërkoi ato ditë të qershorit autorizim për gjashtë aeroplanë transportues për të fluturuar mbi hapësirën ajrore ukrainase dhe hungareze. Por "harruan" t'i informonin këto shtete se këta aeroplanë po bartnin ushtarë elitë dhe të armatosur për t'u vendosur në Kosovë. Si reagim ndaj kësaj situatë, në Evropë, komandanti i NATO-s, Wesley Clark po kërkonte një autorizim tjetër, atë që të goditeshin aeroplanët rusë në rast se do të sillnin ushtarë të tjerë në Sllatinë. Në Kosovë, gjenerali britanik Mike Jackson po ndërmerre çdo gjë që kontingjenti rus të izolohej dhe dorëzohej. Kur amerikani kërkonte veprim, britaniku e theu urdhrin e tij me përgjigjen epike: "Zotëri, s'dua që të filloj Luftën e Tretë Botërore për ju!" Putini ishte strumbullari i kësaj drame të ngjarjeve duke rikonfirmuar qëndrimin rus, të dhënë nga Chernomyrdin. Por, në fakt, kishte ndodhur e kundërta!

Shmangia e konfrontimit

Përplasja NATO-Rusi ishte shumë afër, por drama e Aeroportit të Prishtinës u tejkalua. Rreziku u shmang nga bashkëpunimi i mirëmenduar mes tyre. Historikisht, kjo ngjarje shënon përfshirjen e parë të Putinit në raport me Kosovën dhe do ta përcjellë atë për njëzet vjet me radhë. Mashtrimi në tavolinë negociatash dhe kurthet diplomatike të mbuluara me korrektësi janë vetëm maskim i politikës së tij. Një politikë, e cila synonte të dërgonte forca ushtarake në Kosovë dhe t'i ndryshonte faktet në terren. Ishte një mënyrë, natyrisht e papritur, për ta rikthyer nën kontroll rus diçka që ishte humbur në tavolinën e bisedimeve.

Marshimi i batalionit rus drejt Kosovës, para se trupat paqësore të NATO-s të vendoseshin aty, ishte një platformë e re e sjelljes së jashtme ruse më 1999. Ata synonin një sektor të veçantë të territorit, mundësisht në veri të vendit, kinse në emër të mbrojtjes së serbëve lokalë. Por, e vërteta ishte tjetër - kjo pjesë e Kosovës shihej si një kartë e mirë rajonale gjeopolitike në Ballkan. Natyrisht, një sektor do ta destabilizonte tërë Kosovën dhe do të krijonte parakusht

për një konflikt në mes të NATO-s dhe Rusisë brenda saj. Për më shumë, do ta cenonte rëndë integritetin territorial dhe pavarësinë e Kosovës do të ishte e pamundur më vonë. Gjenerali Clark kujton pritjen ruse për ndarjen e Kosovës që fshihej nën pretendimin e tyre për një sektor të veçantë. Mirëpo, edhe bashkësia ndërkombëtare, e veçanërisht NATO do ta humbte kontrollin e saj mbi tërë misionin.

Putinizmi si doktrinë

Ngjarjet në vitin 1999 janë premiset e kryehershme për ta kuptuar putinizmin si doktrinë të politikës së jashtme deri më sot sa u takon shumë temave ndërkombëtare. Ato nuk ishin thjesht një incident ushtarak dhe ballafaqim diplomatik Rusi-Perëndim, por një mendësi dhe sjellje e re, e ndërtuar mbi një vetëdije historike komplekse ruse. Të frymëzuar nga ideologjia e ringjalljes dhe politika e forcës në raportet ndërkombëtare. Ajo do të kuptohet më vonë si vazhdimësi dhe si qëllim, sikurse treguan ngjarjet e dhunshme në Evropën Lindore, ndërhyrjet brenda BE-së dhe intervenim të stilit carist në Lindje të Mesme.

Përbjekja për ta dështuar bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, misionin e NATO-s dhe Rezolutën 1244 të OKB-së ishin vetëm premiset e para sesi Rusia do të silllet më vonë në rendin e ri ndërkombëtar, duke minuar atë kudo dhe me çdo mjet. Qasja tashmë është e shpallur nga vetë Putini: nuk ka një rend të përbashkët ndërkombëtar, por një botë policentrike me disa qendra të vendimmarrjes. E të gjitha këto duhet të jenë kundër botës perëndimore, veçanërisht kundër "hegjemonisë amerikane".

Rruga e vështirë e Kosovës së pavarur dhe shtetndërtimit të saj për shkak të kundërshtimit rus është tema më interesante dhe dinamike e përplasjeve në raportet Perëndim - Rusi. Mirëpo, më komplekse dhe më

domethënëse është përdorimi i saj për t'i goditur shtetet perëndimore dhe rendin ndërkombëtar që krijoi Kosovën. Që para njëzet vjetësh sjellja gjeopolitike ruse dhe qëndrimi i Putinit tregojnë një veçori afatgjatë. Sa më thellë që kuptohet se çfarë dhe si Putini e ka goditur Kosovën në këta njëzet vjet, aq më mirë do ta shohim "botën e tij". Aq më drejt do ta lexojmë rendin ndërkombëtar dhe, ndoshta, se kush mund të jetë viktimë e politikës ruse sot e në të ardhmen.

Cilat janë elementet e doktrinës së Putinit të përdorura në raport me Kosovën? Ku mund ta shohim putinizmin në veprim diku tjetër në botë?

Kur jemi në prag të festimit të dymbëdhjetëvjetorit të pavarësisë do të mund t'i kujtojmë dy ngjarje fatale për Kosovën si pasojë e putinizmit. Së pari, vendimin rus për ta kundërshtuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së intervenimin humanitar të NATO-s më 1999. Përkundër faktit, që vetë OKB-ja vite me radhë kishte konstatuar, dhe dënua disa herë krimet e Serbisë mbi civilët e pafajshëm në Kosovë. Së dyti, bllokada ruse me kërcënimin për përdorim të vetos në KS të OKB-së më 2007, nëse propozimi për pavarësi të Kosovës do të vihej në tavolinë. Kjo e pamundësoi anëtarësimin e Kosovës në OKB, duke lënë shtetin më të ri në Evropë pa njohje të plotë ndërkombëtare. Ngjarja e parë do ta determinonte natyrën e lirisë sonë, e dyta karakterin e shtetësisë. Pasojat janë të mëdha, por do të ishte një interpretim i thjeshtë nëse vlerësohen goditjet e tij vetëm nën këtë dritë. Dëmi është shumanshëm për Kosovën, ndërsa më vonë viktima të Putnit do të jenë edhe shumë të tjerë. Deri më sot ai do të shfaqet me nostalgji për "Rusinë historike", shpirtin e tij shovinist, vështrimin dhe veprimin përzgjedhës për botën.

REPUBLICA E KOSOVËS KA SHËNUAR 12-VJETORIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË

Kosova feston 12-vjetorin e shtetit

Republika e Kosovës ka festuar 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë. Për nder të 12-vjetorit të shpalljes së pavarësisë liderët shtetërorë kanë urren qytetarët e Kosovës, duke përmendur të arriturat e shtetit më të ri në Evropë dhe sfidat që e presin atë. Për ditën më të veçantë në historinë e Kosovës, institucionet qendrore dhe lokale kanë organizuar aktivitete të ndryshme, ndërsa qytetarët e kanë festuar nëpër të gjitha qytetet e Kosovës. Edhe këtë vit liderët politikë kanë bërë homazhe te kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te varri i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi

**EPOKA E RE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Republika e Kosovës të hënën ka shënuar 12-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. Për nder të 17 shkurtit, ditës më të veçantë në historinë e Kosovës, janë mbajtur shumë aktivitete të organizuara nga institucionet qendrore dhe lokale, ndërsa qytetarët kanë festuar në mënyra të ndryshme nëpër

Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përmes një video-mesazhi në "Facebook" ka urren qytetarët e Kosovës për 12-vjetorin e Pavarësisë. "Ne të gjithë kemi mospajtimet e dallimet tona, por si Qeveri është koha të marrim vendime. Nuk do t'u shmangemi vështirësive, por do t'u bëjmë ballë atyre", ka thënë ai.

Qytetarëve 17 shkurtin ua kanë

e UÇK-së Adem Jashari dhe shumë luftëtarë që u flijuan në altarin e lirisë. Vlerësojmë përpjekjet e pasluftës për ngritjen e institucioneve demokratike dhe përkrahjen e pareshtur të miqve tanë ndërkombëtarë, ShBA-së dhe BE-së", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka urren pavarësinë e Kosovës për të gjithë qytetarët, duke kujtuar sakrificën e popullit shqiptar ndër breza si dhe luftën çlirimtare për liri. "Urimet më të përzemërta bashkëqytetarëve të shtetit tonë dhe mbarë kombit shqiptar për përvjetorin e 12 të pavarësisë së Kosovës. 17 shkurti i vitit 2008

ishte përbushja e një ëndrre të hershme për liri e pavarësi të shumë brezave, prandaj shpreh nderimin për të gjithë ata heronj, luftëtarë e veprimtarë që me sakrificat e tyre shekullore bënë të mundur ditët që gëzojmë sot", ka shkruar Veseli në profilin e tij në "Facebook". Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka nderuar të rënë për këtë ditë. "Përvjetësisht përkulem para sakrificës dhe të rënëve për liri. Sot nderuam, te varri i presidentit Rugova, te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti, në Prekazin e komandantit legjendar Adem Jashari, në Pejën e Haxhi Zekës e Adrian Krasniqit dhe 183 dëshmorëve të Pejës, si dhe në Deçanin e Glllogjanin e heronjve të Dukagjinit. Urimet

bashkëkombës kudo që jeni 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës! Festofshim të bashkuar", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se pavarësia e Kosovës shënon të arriturën më të madhe në historinë e shtetit tonë. "Shpallja e pavarësisë 12 vjet më parë është kurorëzim i përpjekjeve të popullit shqiptar, që kulmuan me luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari dhe mijëra dëshmorë të tjerë", ka shkruar Limaj në "Facebook".

Kosovën për këtë ditë e kanë urren edhe liderët e Shqipërisë, presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe kryetari i PD-së, Lulzim Basha.

Homazhe te varri i Adem Jasharit

17 shkurtin institucionet shtetërore e kanë filluar duke nderuar flamurin shtetëror. Në orën 8:00 të mëngjesit garda ceremoniale e FSK-së, nën intonimin e himnit, ka bërë ngritjen e flamurit në oborrin e qeverisë, ku të pranishëm ishin udhëheqësit shtetërorë dhe komandanti i FSK-së.

Më pas, kryetarja e Kuvendit dhe kryeministri i Kosovës kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te varri i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi.

Kjo ka qenë hera e parë që i pari i qeverisë, Albin Kurti, ka bërë



rrugë e sheshe të qyteteve të Kosovës, të cilat ishin të stolitura me flamuj të Kosovës. Krahas flamujve verdhë e kaltër, qëndronte edhe flamuri kombëtar kuq e zi.

Për ditën më të veçantë në historinë e Kosovës liderët politikë kanë urren qytetarët. Presidenti Hashim Thaçi ka vlerësuar se gjatë këtyre viteve Kosova ka shënuar të arritura si brenda ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. "Gjatë këtyre dymbëdhjetë vjetëve Kosova ka shënuar të arritura të mëdha në rrafshin kombëtar, në konsolidimin e institucioneve, përparimin ekonomik, në kultivimin e marrëdhënieve të mira ndëretnike dhe funksionimin e shtetit ligjor.

Në planin e jashtëm Kosova ka luajtur dhe luan rol paqësor, duke qenë faktor i stabilitetit në rajon. Kosova ka arritur të jetë pjesë e shumë institucioneve ndërkombëtare, me synim të qartë për integrim të plotë në BE, NATO dhe KB", ka shkruar

urrar edhe liderët e partive politike. "Arkitektin e pavarësisë, presidentin historik Ibrahim Rugova, komandantin



Kryesisë, në pritje të sfidave të reja



Thaçi: FSK-ja, pasqyra më e mirë e shoqërisë sonë të lirë dhe demokratike

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka qëndruar të hënën për vizitë në Kazermën "Adem Jashari" në 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Ai ka mbajtur një fjalim, ku tha se ndihet krenar me djemtë e vajzat e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK). "Me punën tuaj jeni bërë institucioni më prestigjioz në përfaqësimin e Kosovës në gara ndërkombëtare krahas për krahas shteteve demokratike dhe ushtrive moderne. Disiplina, etika dhe profesionalizimi juaj vërehen kudo në Kosovë", është shprehur ai.

Ai ka pohuar se Ushtria e Kosovës u rrit së bashku me vitet e lirisë, pavarësisë dhe zhvillimit të saj. "Ushtarë të

nderuar, bazament i ushtrisë janë heronjtë tanë invalidët, veteranët dhe sakrificat e të gjithë qytetarëve. Ushtria e Kosovës është shembulli më i mirë i bashkëpunimit me shtetet që e ndihmuan Kosovën, në krye me ShBA-në, vendet e BE-së dhe NATO-n. Ju jeni ushtri e re, por ushtri moderne. FSK-ja është pasqyra më e mirë e shoqërisë sonë të lirë dhe demokratike. Tashmë në etapën e dytë ushtria e Kosovës synon objektiva të reja. Ju po rriteni në një ushtri kredibile në sytë e botës. Kosova di të jetë prodhuese e paqes, shembull i bashkëpunimit me NATO-n. Kosova në të ardhmen do të jetë pjesë e NATO-s", ka thënë presidenti Thaçi.

Lipa e Rita Ora, tenori Ramë Lahaj e artistja Arta Dobroshti, secili më shumë se tjetri kanë ndikuar që shteti i Kosovës të njihet e të duhet edhe nga popujt e tjerë gjithandej botës. Sot ne e nderojmë veprën e tyre, duke i pasur këtu dy nga ta: Ramën dhe Artën", është shprehur Osmani.

Para fillimit të kësaj seance, deputetet e PDK-së, Ganimete Musliu dhe Evgjeli Thaçi, kanë vendosur flamurin e UÇK-së në Kuvendin e Kosovës.

Ky veprim është bërë si reagim ndaj deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, e cila ditë më parë shpërnda një citat të një analisti serb i cili thoshte se "Albin Kurti s'ka dosje kriminale nga koha e UÇK-së".

FSK-ja nuk parakalon në sheshet e Prishtinës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) këtë vit nuk ka parakaluar në sheshet e Prishtinës sikurse vite më parë. Por, për nder të Ditës së Pavarësisë ushtria ka organizuar dy ceremoni të ndara në Kazermën "Adem Jashari". Në ceremoninë e parë,

qeverisë, Albin Kurti, ka thënë se prioritet i tyre mbetet anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. "Është detyrë e jona të zhvillojmë shtetin nga brenda dhe ta forcojmë nga jashtë. Ne duhet të përballemi me botën ashtu siç është dhe çdoherë duke punuar dhe për ta bërë ashtu si duhet të jetë. 20 vjet kanë kaluar dhe askush s'ka marrë përgjegjësi për gjenocidin dhe të njëjtët mohojnë të drejtën tonë. Ne e dobësojmë shtetin tonë sa herë që e vendosim veten para interesave të shtetit. Ne duhet të jemi unikë në politikën e jashtme. Do të punojmë që ta avancojmë anëtarësimin në NATO dhe BE dhe këto janë prioritetet. Integrimi në BE është rrugë e gjatë, por nevoja na forcon", ka thënë Kurti.

Ai është zotuar se do t'i shtojë investimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Investimet në ushtri dhe në mbrojtje nuk bëhen sepse duam luftë, porse nuk duam që lufta të vijë te ne. Ne investojmë në mbrojtje sepse e keqja ekziston në botë. Në një vend të varfër sikur Kosova, investimet në ushtri janë të kushtueshme, por investimi në mbrojtje është realitet në të cilin rrethohemi. Është detyrë e jona ta zhvillojmë shtetin nga brenda e ta fuqizojmë atë nga jashtë", ka thënë ai, duke se paqja nuk është e garantuar çdoherë.

Kurse kryeparlamentarja Osmani ka thënë se objektivi kryesor i kësaj force është anëtarësimi në NATO. "Të dashur ushtarakë, ju duhet të ndiheni krenarë që jeni pjesë e një formacioni ushtarak i cili ka veç një mision: mbrojtjen e integritetit territorial dhe sigurisë së qytetarëve të Republikës pa dallim. Do të punojmë përshtur që ta bëjmë realitet Kosovën që duam ne, vend të sigurt, ku respektohen kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, vend të zhvilluar ekonomikisht, të integruar në NATO, Bashkimin Evropian dhe në strukturat e tjera euroatlantike. Anëtarësimi në NATO dhe BE mbetet objektivi kryesor strategjik i Republikës sonë për të cilin do të angazhohemi me gjithë potencialin tonë", ka thënë Osmani.

Republika e Kosovës e ka shpallur pavarësinë e saj më 17 shkurti të vitit 2008, në koordinim të plotë me ShBA-në dhe aleatet e tjerë perëndimorë. Deri më tani Kosova është njohur nga 116 shtete dhe dhjetëra organizata ndërkombëtare.

homazhe te varri i ish-presidentit Rugova, ndërsa kryeparlamentarja Vjosa Osmani është bërë zyrtarja e parë e LDK-së që ka bërë homazhe te varri i simbolit të

seancë solemne. Me këtë rast, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova po krijon imazh të ri. Duke iu referuar simbolikës së 12 fëmijëve të pranishëm në

flamurin e Kosovës aty ku nuk ishte e mundur më herët. Ata na kanë bërë të qajmë nga gëzimi e të buzëqeshim nga lumturia. Ju lus që me duartrokitje t'ua kthejmë nderin që ato ia kanë



rezistencës, Adem Demaçi. Me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës edhe anëtarët e Kryesisë dhe deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës kanë bërë homazhe dhe kanë vënë kurora me lule në memorialin e Jasharëve në Prekaz.

Një ditë më parë homazhe në këtë kompleks ka bërë edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli. Homazhe për nder të kësaj dite në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", në Prekaz kanë bërë edhe liderët e tjerë politikë dhe shumë qytetarë nga të gjitha viset shqiptare.

Kuvendi mban seancë për nder të Ditës së Pavarësisë

Për nder të Ditës së Pavarësisë, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur

seancën solemne, të lindur në kohën e pavarësisë, Osmani ka theksuar se bashkë me ta po rritet edhe Republika. "Republika jonë është 12 vjeçe. Ajo e ka afërsisht moshën e këtyre 12 fëmijëve, fëmijëve të pavarësisë, të cilët i shihni këtu dhe të cilët ju ftoj t'i nderojmë. Ata kanë lindur me shtetin dhe janë rritur krahas shtetit, të cilin po e ndërtojmë përditë e nga pak, duke u siguruar që Kosova të jetë strehë e sigurt dhe vend ku këta fëmijë do ta jetojnë të tashmen dhe ta ndërtojmë të ardhmen e tyre", ka theksuar Osmani, duke përmendur arritjet e disa kosovarëve në shumë sfera. "Xhudistet Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, bashkë me trajnerin e tyre, Toni Kukën, e kanë skalitur emrin e Kosovës në qindra piedestale, deri në olimpiadën e Brazilit, duke e lartësuar



bërë shtetit të tyre", ka thënë Osmani. Sipas saj, për imazhin po kontribuojnë edhe futbollistët e kombëtares kosovare, por edhe artistët tanë me famë botërore. "Artistët janë vlera shpirtërore që neve po na bëjnë të njohur në botë. Nga këngëtarët Dua

para ushtarëve të FSK-së kanë folur kryeparlamentarja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, ndërsa në ceremoninë e dytë që është organizuar pasdite ka folur presidenti Hashim Thaçi, i cili paradite ka qenë në një vizitë jashtë vendit. Para ushtarëve të FSK-së, i pari i



Pompeo uron Kosovën në 12-vjetorin e pavarësisë

PRISHTINË, 17 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka përgëzuar Kosovën në përvjetorin e 12-të të pavarësisë së saj, duke thënë se sovraniteti dhe pavarësia e këtij shteti janë shumë të rëndësishme për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Në komunikatën e lëshuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit është thënë se Shtetet e Bashkuara janë të motivuara nga ngjarjet e fundit, që janë shenjë e lehtësimit të investimeve, turizmit, tregtisë dhe lidhjeve me Serbinë. Me këtë rast, Pompeo duket se u është referuar marrëveshjeve të arritura mes zyrtarëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë për vendosjen e linjave ajrore dhe atyre hekurudhore në mes të dy vendeve. Nënshkrimi i marrëveshjeve është lehtësuar nga ambasadori

amerikan në Berlin, Richard Grenell. Sipas Pompeo, këto zhvillime shtrojnë rrugën për përparim më të madh në normalizim të marrëdhënieve në të ardhmen e afërt. Sekretari amerikan ka përmendur edhe gatishmërinë e ShBA-së për ta vazhduar bashkëpunimin me Kosovën. "Për më shumë se një dekadë të dy shtetet kanë gëzuar lidhje të forta, të bazuara në vlera të përbashkëta. Shtetet e Bashkuara mbështesin Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit në institucionet transatlantike dhe do të vazhdojnë të punojnë për fuqizim të sundimit të ligjit, luftim të korrupsionit dhe nxitjes së begatisë ekonomike për të gjithë qytetarët e Kosovës", është thënë në komunikatën e Departamentit Amerikan të Shtetit.



'Ukshin Hoti' arrin marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Prizrenit

PRIZREN, 17 SHKURT (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit dhe Komuna e Prizrenit kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja është nënshkruar nga rektori prof. asoc. dr. Ismet Temaj dhe kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka.

Përfaqësuesit e dy institucioneve e vlerësuan lart thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Rektori Temaj e ka falënderuar kryetarin e Prizrenit për mbështetjen duke theksuar se arritja e kësaj marrëveshje shkon në funksion të lidhjes së ngushtë të universitetit me palët e interesin dhe në këtë kuadër bashkëpunimi me pushtetin lokal ka shumë rëndësi për të ardhmen e universitetit.

Ndërkaq, kryetari Haskuka vazhdimisht e ka mbështetur universitetin. Ai ka theksuar se për zhvillimin e gjithëmbarshtëm pikë kyçe është lidhja e arsimit me ekonominë, ndërsa roli i Universitetit të Prizrenit në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm.

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është t'i përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Dy institucionet pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen



Rektori Temaj e ka falënderuar kryetarin e Prizrenit për mbështetjen duke theksuar se arritja e kësaj marrëveshje shkon në funksion të lidhjes së ngushtë të universitetit me palët e interesin dhe në këtë kuadër bashkëpunimi me pushtetin lokal ka shumë rëndësi për të ardhmen e universitetit.

Kryetari Haskuka vazhdimisht e ka mbështetur universitetin. Ai ka theksuar se për zhvillimin e gjithëmbarshtëm pikë kyçe është lidhja e arsimit me ekonominë, ndërsa roli i Universitetit të Prizrenit në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm

profesionale të studentëve të Universitetit.

Komuna e Prizrenit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit së bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, për ofrim të shërbimeve përkatëse për këtë universitet, për gjenerimin e

punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë.

Në këtë aspekt, Universiteti i Prizrenit do t'i ofrojë ndihmë shkencore-profesionale Komunës së Prizrenit me shërbimet e veta.

Komuna e Prizrenit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe

realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social në Prizren, hartimin e analizave ekonomike, në mënyrë të rregullt të paraqesin ofrimin e përbashkët dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin projekteve. Komuna e Prizrenit do të

pranojnë në baza mujore një numër të studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit për të bërë praktikën profesionale nëpër zyrat e Komunës dhe institucioneve vartëse.

Komuna e Prizrenit do të angazhohet që të ofrojë bursa për studentët më të dalluar të Universitetit dhe me gjendje të rënduar ekonomike, përfshirë edhe familjet e dëshmorëve.

Komuna e Prizrenit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" pajtohen që për nevoja të tyre të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Komuna e Prizrenit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" pajtohen që të angazhohet një doktor i mjekësisë familjare dhe një infermier në kompleksin e universitetit. Gjithashtu, këto dy institucione pajtohen për shfrytëzimin e institucioneve dhe hapësirave komunale për studentët, si: Bibliotekën Komunale, Qendrën Sportive "Sezai Surroi", fushat sportive, institucionet kulturore komunale etj.

Po ashtu, Komuna e Prizrenit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të planeve dhe dokumenteve strategjike të dy palëve si dhe pajtohen që ta planifikojë ndarjen e hapësirave dhe tokës komunale për nevoja të zgjerimit të infrastrukturës të UPZ-së dhe për nevoja specifike të fakulteteve përkatëse konform ligjeve në fuqi.

Qytetarët mbesin të lidhur ngushtë me flamurin kuq e zi

Shumë qytetarë mbesin të lidhur ngushtë me flamurin kuq e zi, porse është në rritje numri i atyre që kanë krijuar lidhje me flamurin shtetëror, sidomos pas sukseseve të Kosovës në sporte të ndryshme



dhe te qytetarët e Kosovës ende dominojnë ndenja të fuqishme për flamurin kuq e zi.

Kushtrim Sheremeti, aktor dhe aktivist politik, ka lidhje të veçantë me këtë flamur. "Unë jam komplet kuq e zi", ka thënë ai, duke treguar se sa ka qenë për tre vjet pjesë e Qeverisë së Kosovës e ka bartur në zyrë flamurin shtetëror për arsye që, sipas tij, ka qenë flamuri për të cilin ka punuar në institucionet shtetërore. "Më ka përfaqësuar institucionet dhe shtetin ku jetoj", ka thënë ai.

Sa iu takon datave historike, qytetarët e Kosovës kanë dy festa kryesore: 28 Nëntorin - shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe 17 Shkurtin - shpalljen e Pavarësisë së

Kosovës. Në këto dy data qytetarët festojnë me të dy flamujt, flamurin kuq e zi dhe atë të shtetit të Kosovës. Në shumicën e vendeve ku vendoset flamuri i Kosovës, vendoset edhe ai i Shqipërisë.

Publicisti Shkëlzen Maliqi thotë se flamuri i Kosovës nuk është i pëlqyeshëm pasi është zgjedhur pa pyetur qytetarët, të cilët, sipas tij, është dashur që të kenë të drejtë të vendosin për simbolin që i përfaqëson.

Qytetarët janë të ndarë në mendime sa i takon flamurit. Disa besojnë se Kosova do të ketë një flamur tjetër në të ardhmen.

Ekrem Rexha, student, thotë se në aspektin personal është i lidhur me flamurin kuq e zi.

Agim Smakaj thotë se në të gjitha arritjet që i kemi pasur në sport është ngritur flamuri i Kosovës. "Prandaj është një arritje me atë flamur derisa të vijë koha të krijojmë një flamur tjetër, duhet këtë që e kemi ta përkrahim dhe ta duam", ka thënë Smakaj.

Përzgjedhja e flamurit të Kosovës u bë pas një konkursi ndërkombëtar ku u vlerësuan rreth 1000 versione. Përpos hartës, flamuri shtetëror ka të vendosur gjashtë yje që nënkuptojnë gjashtë grupet kryesore etnike që jetojnë në Kosovë. (REL)

PRISHTINË, 17 SHKURT - Shumë qytetarë kanë dalë të hënën në sheshet e Prishtinës për ta festuar përvjetorin e 12-të të pavarësisë së Kosovës. Prishtina është dekoruar me ngjyrat e flamurit verdhë e kaltër, por shumë qytetarë mbajnë me vete edhe flamurin kuq e zi. Aktivitete të ndryshme për 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës kanë organizuar edhe komunat e tjera.

Janë bërë 12 vjet prej se Kosova shpalli pavarësinë dhe qytetarët mbesin të ndarë sa i takon ndjenjës që ata kanë për

flamurin kombëtar shqiptar dhe atë të shtetit të Kosovës. Shumë qytetarë mbesin të lidhur ngushtë me flamurin kuq e zi, porse është në rritje numri i atyre që kanë krijuar lidhje me flamurin shtetëror, sidomos pas sukseseve të Kosovës në sporte të ndryshme.

Hendbollisti Kastriot Jupa, i cili luan për përfaqësuesen e Kosovës, ka thënë për "Radio Evropa e Lirë" se ndihet krenar që ka mundësinë t'i përfaqësojë ngjyrat e shtetit të tij.

Nga dita e shpalljes së pavarësisë kanë kaluar 12 vjet



'NewBorn'-i me pamje të re

Para shumë qytetarëve është prezantuar të hënën obelisku "NewBorn" me pamje të re, i cili këtë vit iu kushtohet të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës. Në çdo shkronjë kishte një mbishkrim që ishte shkruar nga të dhunuarat seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 SHKURT - Me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është prezantuar pamja e re e obeliskut "NewBorn", që këtë vit iu kushtua të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës. Në prezantim ishin të pranishme shumë deputete nga Kuvendi i Kosovës dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani.

Drejtoresha e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës, Feride



Rushiti, ka vlerësuar lart mesazhin që përçon këtë vit obelisku "NewBorn". "Falënderoj Fisnik Ismailin që këtë vit ua ka kushtuar viktimave të dhunës seksuale, pasi nëpërmjet këtij obelisku do të pasqyrohet dhuna që kanë përjetuar viktimat", ka thënë ajo.

Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se gratë e dhunuara do të jenë nderi ynë i përjetshëm. "Jo vetëm ky organizim, dedikim i sotëm do të jetë zëri ynë në institucione, por i gjithë zëri i qytetarëve të Kosovës për ta luftuar stigmën është i nevojshëm në mënyrë që



ta nderojmë sakrificën të cilën e kanë përjetuar gratë dhe burrat në Kosovë. Sot kur i shikojmë këto citime të drejtpërdrejta nga gratë e dhunuara gjatë luftës, ku njëra prej tyre më bëri përshtypje e që thotë: 'Dua që plaga ime të ketë zë'. Dëshiroj që të zotohemi që ajo plagë të ketë zë sot e

përgjithmonë", ka thënë Osmani. I pranishëm ishte edhe vëllai i Vashije Krasniqit, i cili ftoi për mbështetje ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Vjosa Osmani dhe Feride Rushiti bashkë me shumë deputete të Kuvendit vendosën lule te monumenti "Heroinat".



Për 12 vjet shtet, Kosova nuk pati rritje të nevojshme ekonomike

Për dymbëdhjetë vjet të shtetësisë, Kosova nuk ka shënuar rritjen e nevojshme ekonomike. Kështu kanë thënë njohës të fushës së ekonomisë që, sipas tyre, kjo rritje ekonomike do të duhej të ishte 7 për qind. Sipas njohësve të çështjeve ekonomike, Muhamet Mustafa dhe Safet Gërxhaliu, Kosova gjatë këtyre viteve është përballur me debalancë të lartë tregtar, papunësi, mospasje në nivel të duhur të investimeve të huaja, administratë publike të madhe dhe të shtrenjtë. Ndërkaq, gjë pozitive, sipas tyre, është konsideruar investimi në infrastrukturën rrugore si dhe partneriteti me FMN-në dhe BB-në. Kurse prodhuesi vendor nga fabrika “Meka”, Burim Piraj, ka folur për bashkëpunimin tregtar me Shqipërinë që, sipas tij, edhe pse eksporti është në shifër simbolike, tanimë s’ka pengesa tregtare në mes të dy vendeve

konsiderueshme në fushat e ndryshme. Por, ajo që duhet të jetë brengë për qytetarët e Kosovës, është zhvillimi ekonomik, por meqë kishim politikanë që janë marrë me populizëm dhe folklorizëm sesa me zhvillim ekonomik, jemi këtu ku jemi. Kemi tri vjet të humbura me demarkacion, dy vjet e gjysmë me taksë, që është dëmi më i madh që i është bërë Kosovës. Në këtë drejtim nuk pritet të kemi investime pasi sundimi i rendit dhe ligjit ka qenë pika më e dobët. Rënia e investimeve të huaja është më shqetësuese derisa vendet e rajonit bëjnë gara dhe seleksionime për investime të huaja, Kosova ka mbetur larg në këtë aspekt. Po ashtu, është shqetësuese prishja e raportove me miqtë ndërkombëtarë. Në një shtet ku definitivisht administrata publike ka qenë krijuese e vendeve të reja të punës, dëshmon mjerimin e ekonomisë. Është për t’u shqetësuar niveli i ulët i eksportit, ku pjesa dërrmuese përbën mbeturinat metalike. Besoj dhe jam i vetëdijshëm se është koha e fundit ku të gjithë duhet të mobilizohemi që për ekonominë të bëjmë më tepër.

Interesi i shtetit duhet të jetë mbi interesat e partive politike”, ka thënë ai.

Gërxhaliu ka theksuar se duhet të kuptohet që vetëm me zhvillim ekonomik të bazuar në rend dhe ligj Kosova do ta arrijë stabilitetin politik, social dhe do t’i përshpejtojë proceset integruese dhe, sipas tij, mbi të gjitha, do ta përmirësojë imazhin e vet që është në pikën më kritike falë gabimeve të politikëbërësve. Ai ka shtuar se në të kaluarën ishte për t’u duartrokatur raporti me FMN-në, Bankën Botërore, partneriteti me ShBA-në dhe vendet evropiane. Sipas tij, tërë kjo është venituri kur në Kosovë erdhi një klasë politike që shumë më shumë humbte kohë për ta ndryshuar të kaluarën sesa për të ndërtuar të ardhmen. “Jo vetëm që janë zhgënjyer qytetarët me ikjen masive nga Kosova, por i kemi zhgënjyer edhe ndërkombëtarët që ishin sponsorizuesit më të fuqishëm të Kosovës”, ka thënë Gërxhaliu. Ai ka theksuar se Kosova është shndërruar në një shoqëri që varet nga importi. “Kur dihet që proporcioni është 9/1 ose 90/10, në këtë mënyrë Kosova është shndërruar në një vend ku

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24-vjeçare me 48.9 për qind. Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), në TM3 2019 fuqia joaktive është mjaft e lartë me 58.1 për qind, me fokus të veçantë të femrat me 77.8 për qind, krahasuar me meshkujt 38.6 për qind. Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 17.5 për qind, ndërtimtaria me 13.5 për qind, prodhimi me 12.5 për qind, si

dhe arsimit me 8.9 për qind. Ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim.

Kurse të dhënat nga tregtia e jashtme të mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për (12.7 për qind) në muajin dhjetor 2019, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Sa i përket varfërisë, rreth 25 mijë familje në tërë Kosovën konsiderohet se jetojnë vetëm me asistencë sociale. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, Kosova kishte filluar vitin e pavarësisë më 2008 me një rritje ekonomike mbi 5 për qind, por më pas këtë shkallë të rritjes ekonomike nuk e kishte arritur më.

Lidhur me këtë, Safet Gërxhaliu, sekretar gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, ka thënë për gazetën “Epoka e re” se, me gjithë sfidat, janë arritur rezultate të mira të fushës së ekonomisë por, sipas tij, ende mbetet për t’u dëshiruar sa i përket rritjes ekonomike, tërheqjes së investimeve të huaja, punësimit dhe raporteve me institucionet ndërkombëtare e që, sipas tij, fatura për të gjitha dështimet iu përket politikëbërësve të cilët neglizhuan agjendën ekonomike. “Dymbëdhjetë vjet shtet është periudhë kohore mjaft e gjatë, por besoj se janë arritur rezultate të

investitorët e huaj nuk janë të interesuar”, është shprehur ai. Sa i përket bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Shqipëri, Gërxhaliu ka thënë se është për keqardhje. Ai ka thënë se mungesën e gatishmërisë për bashkëpunim të Kosovës dhe Shqipërisë e kanë shfrytëzuar vendet e rajonit, Serbia, Maqedonia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Bosnja. “Ne duhet ta ndërtojmë një treg bazuar në interes dhe jo në emocione apo marketing politik”, ka thënë ai. Profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka thënë për gazetën “Epoka e re” se gjatë këtyre 12 vjetëve për nevojat e zhvillimit ekonomik, rritjen ekonomike na është dashur të kalojmë në norma mbi 7 për qind për të pasur ekonomi të qëndrueshme. “Do t’i konsideroja më tepër si arritje, edhe pse kishim një rritje ekonomike me norma të ndryshme, por në shumicën e kohës deri në 4 për qind, rrallë ka kaluar në norma të larta. Për nevojat e zhvillimit ekonomik ne është dashur të kalojmë në norma mbi 7 për qind për të pasur ekonomi të qëndrueshme. Ne kemi rezultate në zhvillimin e infrastrukturës rrugore, edhe

pse kostoja e tyre duket të jetë e lartë. Kanë mbetur shumë projekte zvarrë, kurse problem më i madh është investimi në burime njerëzore, edukim dhe shëndetësi”, ka thënë Mustafa, duke shtuar se sukseset e tjera mund të thuhet se janë gjysmake. “Nëse i shihni investimet në sektorin privat, ato janë modeste. Kemi eksport shërbimesh dhe blerjet e diasporës. Investimet publike dhe private duhet të jenë 700 milionë euro më të mëdha në mënyrë që të rritet punësimi dhe të rritet shpresa te qytetarët, duke përmirësuar kështu imazhin dhe duke bërë rregull në rend dhe ligj. Ne kemi zhvilluar një administratë publike të shtrenjtë dhe të madhe për nga numri dhe fatura e pagave që ka kjo administratë. Pra, edhe pa rritjet që janë në ligjin i cili ndodhet në Gjykatën Kushtetuese, është tepër e madhe. Të gjitha këto janë pengesa”, u shpreh ai. Mustafa ka folur edhe për marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë. “Ne jemi sjell në mënyrë inferiore dhe kemi lejuar që eksportet e tyre në Kosovë të kenë shumë avantazhe”, ka thënë Mustafa.

Piraj: Në Serbi ka një urrëjtje shumë të madhe për çdo gjë që është shqiptare ose kosovare

Prodhuesi vendor nga fabrika “Meka”, Burim Piraj, ka folur për bashkëpunimin tregtar me Shqipërinë që, sipas tij, edhe pse eksporti është në shifër simbolike, tanimë s’ka pengesa tregtare ndërmjet dy vendeve. “Ne si kompani eksportojmë në Shqipëri, nuk është ndonjë eksport shumë i lartë dhe merr një përqindje më të vogël se 3 për qind të prodhimit dhe shitjeve të gjithëmbarshme. Vitin e fundit nuk kemi pasur pengesa dhe jemi të kënaqur me qasjen e autoriteteve kufitare të Shqipërisë dhe me trajtimin. Normalisht që prodhimet e mishit kërkojnë dokumentacion shtesë dhe kushte të transportit të rregullta, por ne i plotësojmë ato dhe nuk kemi pengesa”, ka thënë Piraj. Ai ka folur edhe për kërkesat rreth prodhimit të tij që kishite më parë shteti serb, por që për shkaqe nacionale, sipas tij, nuk kishite bashkëpunim. “Nga Serbia para shumë vitesh kemi pasur kërkesë për



bashkëpunim, mirëpo për shkak të presionit publik dhe frikës, firmat serbe dhe ato shqiptare që veprojnë në Serbi hezitojnë të importojnë nga Kosova. Në Serbi ka një urrëjtje shumë të madhe për çdo gjë që është shqiptare. Kush mendon se është ndryshe le të shkojë në Beograd dhe të flasë shqipe do ta shikojë se si e trajtojnë kamerierët, ndoshta edhe nuk i shërbejnë”, ka thënë Piraj, duke shtuar se derisa ne, në Kosovë, shumë elementeve pro serbe u japim edhe hapësirë në media atje, sipas tij, njerëzit e kanë gati të pamundur diçka ‘Made in Kosova’ të nxjerrin në treg.

Shqipëria siguron qindra miliona euro në Konferencën e Donatorëve për dëmet nga tërmeti

PRISHTINE, 17 SHKURT - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, në Konferencën e Donatorëve në Bruksel ka bërë me dije të hënën se BE-ja do të japë 100 milionë euro për Shqipërinë, pa llogaritur 15 milionët që ka dhënë Komisioni Evropian menjëherë pas tërmetit. “Ne kemi dëgjuar histori që të prekin zemrën nga kjo tragjedi. Kjo është një histori dhimbje dhe histori shërimi. Kjo pjesëmarrje dëshmon se ne jemi në krahun tuaj. Solidariteti shpëtoi jetë njerëzish nga kjo tragjedi shqiptare. Nevojat e Shqipërisë janë të mëdha dhe urgjente. Sot ne jemi këtu të dëshmojmë dhe t’i marrim angazhimet tona për popullin shqiptar. Ne bashkë duhet ta bëjmë Shqipërinë më të fortë”, ka thënë de Leyen. Ndërkaq Gjermania do të japë 11 milionë euro ndihmë financiare për rindërtimin në Shqipëri, pas tërmetit. Këtë e ka bërë me dije të hënën ministri i Jashtëm Federal, Heiko Maas, në Konferencën e Donatorëve në Bruksel. “Tërmeti i rëndë i nëntorit, që goditi Shqipërinë, mori 51 jetë njerëzish dhe shkaktoi dëme serioze. Gjermania ofroi menjëherë ndihmën e saj nëpërmjet ekspertëve të Agjencisë të Asistencës Teknike. Por tani bëhet fjalë për rindërtimin. Qytetarët në zonat e prekura kanë nevojë për banesa, shkolla dhe kopshte. Gjermania vë në dispozicion për këtë 11 milionë euro. Është një dëshmi e fortë e solidaritetit të BE-së me Shqipërinë fakti që Komisioni Evropian po koordinon asistencën ndërkombëtare të emergjencës dhe ka thirrur për këtë qëllim konferencën e sotme të donatorëve”, ka thënë Maas. Ndërkaq Italia ka dhënë 65 milionë euro, kurse Suedia 5.6 milionë euro. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën e mbajtur gjatë

kësaj konference u kërkoi ndihmë të gjitha vendeve ta ndihmojnë Shqipërinë. “Ju lutem na ndihmoni ndërsa përpiqemi ta rimarrim veten nga dëmet”, tha ai duke falënderuar shumë shtete në gjuhën e tyre për ndihmën e dhënë menjëherë pas tërmetit. Rama, ndër të tjera, tha se Shqipëria pësoi edhe një “tërmet politik” kur nuk i hapi negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe shtoi se do të donte ta shihte flamurin e Shqipërisë në vend të atij të Britanisë së Madhe. “Për vendin tonë tërmeti politik në tetor u ndje si mallkimi i shoqërisë që na godiste edhe një herë. Zgjerimi është një nga çështjet që kemi në diskutim në familjen e BE-së. Është i vështirë dhe jo gjithmonë janë kohët më të lehta për të jetuar në union, por për ne që kemi bërë kaq shumë për t’u bërë pjesë e kësaj familjeje, mohimi i kësaj lëvizjeje ishte goditje e madhe, u goditëm sikur na ishte marrë fryma. Ndjemë dhimbjen, poshtërimin, ju lutem vlerësoni thellësinë e këtyre ndjenjave. Bëmë gjithçka mundëm dhe na u kërkua, e përsëri përgjigjja ishte jo. Dy goditje të forta, dhe ende qëndrojmë për një të ardhme më të mirë të fëmijëve tanë. Jam i inkurajuar nga metodologjia e re, e propozimit të Francës për diskutim dhe, gjithashtu, edhe reagimin e Komisionit për të bërë më të mirën në Bruksel dhe në vend. Në fund të 2019-s, ndërkohë që viti solli dy ditë të këqija për vendin tim, le të shënojë 2020 një vit rindërtimi, solidaritet e shprese. Besoj fort se interesi është i ndërsjellë ashtu si e ardhmja e BE-së dhe e Ballkanit Perëndimor”, ka thënë Rama. Ai shtoi se është i inkurajuar nga metodologjia e re e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Shqipëria

LISTA E SHTETEVE QË NDIHMUAN SHQIPËRINË ME SHUMA MONETARE

Holanda - 3 milionë euro grante
 Danimarka - 2.7 milionë euro
 Polonia - 2.7 milionë euro
 Greqia - 2.5 milionë euro dhe ndërtimin e 200 banesave
 Gjermania - 11 milionë euro
 Suedia - 5.6 milionë euro
 Bosnja dhe Hercegovina - 100 mijë marka
 Britania e Madhe - 1 milion paund
 Kroacia - 1 milion euro
 Kosova - 200 mijë euro në formën e granteve
 Italia - 65 milionë euro
 Sllovakia - 250 mijë euro
 Austria - 1 milion euro
 Franca - 60 milionë euro hua
 Sllovenia - 300 mijë euro
 Çekia - 9.5 milionë korona çeke
 Maqedonia e Veriut - 97 mijë euro
 Finlanda - 300 mijë euro
 Luksemburgu - 150 mijë euro
 Spanja - 25 mijë euro
 Bullgaria - 100 mijë euro
 Hungaria - 250 mijë euro
 Irlanda - 300 mijë euro
 Mali i Zi - 500 mijë euro
 Serbia - 2 milionë euro grant
 Ndërkohë që BE-ja 100 milionë euro dhe KE-ja 15 milionë euro.

synon që gjatë kësaj konference të mbledhë së paku 350 milionë euro përmes investimeve, kredive të buta dhe ndihmës për rindërtimin e vendeve të prekura. Tërmeti me magnitudë 6.3 ballë të Rihterit, i cili ka goditur Shqipërinë më 26 nëntor, ka qenë më i fuqishmi që ka goditur këtë vend gjatë dekadave të fundit dhe për pasojë ka lënë 51 persona të vdekur, qindra të lënduar dhe mijëra persona të pastrehë si pasojë e shembjeve, dëmtimeve serioze dhe rrezikshmërisë që paraqesin vendbanimet e tyre.



Politika serbe e kryqëzuar midis Kishës dhe Akademisë



Prof. Lisen BASHKURTI

Në dukje të parë po krijohet përshtypja se diplomacia perëndimore, ShBA-ja dhe BE-ja, po lëvizin drejt trajektore Serbi - Kosovë, për të shkuar drejt një marrëveshje të shumëpritur por, në të vërtetë, larg për t'u arritur. Edhe Kosova po lëviz në mënyrën e saj, ndonëse jo krejt e qartë dhe jo në mënyrë kohezive. Krahu më i ngurtë, që nuk po lëviz fare nga pozicioni i saj, është Serbia, e mbështetur në mënyrën e vet nga Rusia. Pra, kemi qartazi të bëjmë me një dinamikë diplomatike asimetrike: Perëndimi po nxiton dhe Kosova po lëviz, ndërsa Rusia po frenon dhe Serbia po bllokton. Një situatë e tillë diplomatike asimetrike, ku njëri krah lëviz me nxitim ndërsa krahu tjetër bllokton me qëllim, është shkaktuar më së shumti nga fakti se në aksionin diplomatik perëndimor aktual në Ballkan janë përfshirë liderë politikë dhe aktorë diplomatikë që e njohin pak ose aspak politikën dhe diplomacinë serbe dhe prapavijën e saj ruse dhe për këtë arsye mund të bien lehtësisht në kurthin e tyre. Në thelb, Serbia është viktimë e vetvetes. Dhe, si e tillë, është e gatshme t'i viktimizojë edhe vendet e popujt përreth saj. Do të ishte luzion mjeran, nga politika dhe diplomacia perëndimore, të mendohej se Serbia është në duart e Vuçiqit, sado i fuqishëm që të jetë ai politikisht. Për të kuptuar këtë situatë është e domosdoshme të depërtohet në aktorët dhe procedurat e vërteta të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Serbi.

1. Kisha serbe, pronare e politikës dhe diplomacisë së saj

Kleri serb ka pronësi të fortë mbi historinë politike të Serbisë. Historia e Serbisë është në thelb

historia e kishës ortodokse të saj. Historia e përgjithshme, por edhe historia kishtarë pravosllave serbe pohon se kleri ortodoks serb dhe institucionet e tyre kanë qenë dhe kanë mbetur aktive gjatë tërë kohës. Madje, roli i klerikëve dhe monakëve theksohet me ditirambe të veçanta pasi monakët dhe klerikët kontribuuan "jo vetëm me kryq në dorë dhe me qaforet rreth qafës, por edhe me shpatë, pistoletë në brez dhe pushkë në krah". Shumë prej tyre shkuan në luftë jo si kryqtarë popullorë, por si ushtarë të thjeshtë. Në shekullin 19 ky aktivitet është shfaqur gjatë kryengritjes së përgjithshme kundër Turqisë. Kryengritjet në Shumadi 1804, në Zhicko Polje në 1806, në Lopas në 1806, në Dragashevë në 1807, klerikët ortodoksë serbë në mobilizimin e njerëzve, por edhe me shembull ushtarak personal.

Kleri serb ka pronësi të fortë edhe në diplomacinë serbe sepse klerikët serbë kanë qenë dhe mbeten aktivë edhe në diplomaci. Prota Matija është organizatori kryesor i serbëve përtej Kollubarës në vitin 1803 kundër Turqisë. Proto Matija ishte në Petrograd te Cari rus Aleksandër, në Greqi dhe në vende të tjera me misionë kishtarë e diplomatike. Aktiviteti kishtar serb brenda dhe jashtë nuk pushoi deri në ditët tona. Në këtë veprimtari kisha serbe ruan dhe përçon frymën shoviniste të politikës dhe diplomacisë serbe. Kleri serb ka krijuar simbiozën e pashqitshme fe-politikë. Në jetën fetare dhe politike serbe organet më të rëndësishme janë sinodet ose kuvendet e etërve të shenjtë. Sinodet janë të përgjithshme dhe ndërkombëtare, por janë edhe specifike dhe lokale. Të njohur si kuvendet vasselane, këto institucione kanë qenë dhe mbeten më të rëndësishmit në jetën shpirtërore të Serbisë dhe me ndikim absolut mbi politikën dhe shtetin e saj. Kleri serb ka mitifikuar historinë e Ballkanit, të Serbisë dhe të Kosovës. Sipas saj, martiri i serbëve, Princ Llazari, ka luftuar për një popull qiellor dhe në një tokë qiellore, që është Kosova, Jerusalemi i ri i Zotit.

Këtyre dogmave fetare historia serbe i ka bërë jehonë me tezat fikse. Shkenca serbe, sidomos historia, gjeografia nuk kanë dalë asnjëherë jashtë kuadrin të dogmave të përcaktuara nga kisha serbe. Dogmat e kishës serbe kanë qenë themeli mbi të cilën janë ngritur historia dhe gjeografia e Serbisë e, siç dihet, historia dhe gjeografia të manipuluar serbe janë prindërit e politikës së saj. Burimet kryesore të doktrinës fetare-politike serbo-sllave janë edhe kronikat e murgjve serbë, që shprehin në vetëdijen tribale, popullin serb deri në ditët e sotme. Kjo ideologji, në vend të kombit e thekson popullin, në kuptim të "popullit qiellor", madhësia e të cilit nuk është raca, por "dhurata e Zotit". Sipas klerit serb, kjo hyjni nuk dihet përse u është privuar popujve të tjerë, por u është dhënë vetëm serbëve në Kosovë. Në këtë mënyrë, shkenca dhe teoritë shkencore ia lëshojnë vendin mitologjisë dhe religjionit, që ky të transformohet në doktrinë fetare-politike serbe për ta konfirmuar këtë lajthitje.

Konceptet politike, religjioze, ushtarake ekstreme dhe perverse serbe-ortodokse kanë ndikuar që edhe njerëzit më përgjegjës të ortodoksizmit, të politikës dhe të shkencës, të bien në kurthet vicioze, mistike dhe obskurantiste. Vetëdija e tillë dogmatike dhe perverse ka krijuar dhe krijon psikopati politike e religjioze, të cilët gjatë historisë humbjet i konsiderojnë si fitore, kurse 'zotimin' për Kosovën e bëjnë fundament për luftëra gjenocidale. Kjo vetëdije dogmatike, mistike dhe obskurante e shtynë edhe sot Kishën Ortodokse serbe, peshkopin Artemije të nxisin ekstremizmin e dhunshëm, duke manipuluar masat serbe me eshtrat e princ Llazarit, i cili burimet e veta nuk i ka të shenjtë, por i ka nga lëvizja hajdute e çetnike, që provohen dukshëm nga kronikat e përmendura më herët nga epika mesjetare serbe. Kleri serb, për arsyet e mësipërme, nuk e lëshon pronësinë mbi politikën, diplomacinë, shkencën e Serbisë. Me një autoritet absolut

mbi vetëdijen popullore serbe, kleri serb kontrollon me një dominim të padiskutueshëm politikëbërjen dhe vendimmarrjen në Serbi. Rreth tij, vërtiten si kukulla, liderët dhe institucionet politike serbe. Çdo përpjekje e politikanëve serbë për të dalë nga ky rreth vicioz dogmatik, mistik dhe obskurant i klerit është shoqëruar më së paku me largimin nga skena politike, më së shumti me eliminimin fizik të tyre.

2. Akademia serbe, autore e doktrinave nacional-shoviniste

Lëvizja nacionaliste shtetformuese serbe në shekullin 19 është paraprirë dhe bashkëshoqëruar ngushtësisht nga akademikët serbë. Ilija Garashanini, i pari shtetar modern, ministër i Brendshëm dhe kryeministër i Serbisë, përgatiti elaboratin e tij në vitin 1844 me emrin 'Načertanije'. Ky dokument udhëhoqi politikën serbe drejt aspiratës për 'Serbinë e Madhe'. Dokumenti mbeti sekret deri në vitin 1906, duke ndikuar vetëm në qarqe politike, por jo popullore, së paku gjatë shekullit 19. Të pakënaqur nga mosrealizimi i platformës së Garashaninit, akademikët serbë të shekullit 20-të, në krye me Vasa Çubriloviqin, avancuan më tej në programin e tyre politik. Dr. Vaso Çubriloviq ka qenë këshilltar i regjimit monarkist, pastaj ministër, akademik, drejtor i Institutit të Ballkanologjisë dhe anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky akademik serb botoi memorandumun e tij "Dëbimi i shqiptarëve", që iu paraqit qeverisë mbretërore të Stojadonoviçit më 7 mars 1937, dhe ka shërbyer si platforma kryesore për spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë. Memorandumi i Çubriloviçit mbetet valid edhe sot për politikën serbe. Nuk ka asnjë dokument, asnjë rezolutë, apo edhe deklaratë goftë edhe individuale nga akademikët serbë deri më sot ta kenë kontestuar memorandumun e Çubriloviçit.

Është rast unik në botë në historinë e akademizmit që një akademik të ketë hartuar një platformë që arsyeton dhunën, gjenocidin dhe pastrimin etnik të një populli dhe, çfarë është edhe më e rëndë, që nuk kontestohet as edhe nga një zë i vetëm akademik. Në frymën e Çubriloviçit mendon, sillet e vepron edhe sot Akademia e Shkencave dhe Arteve e Serbisë. Kështu, historiani dhe akademiku serb Vasilije Krestiq ka thënë pak kohë më parë se "Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë për çfarëdo çmimi nuk do të heqë dorë nga Kosova". "Në pikëvështrimin tim, thotë ai, Akademia do të qëndrojë në pikën ku nuk do t'i çojë duart nga Kosova dhe Metohija, për asnjë çmim". "Kjo është pse nuk ka një njohje formale të shtetit të vetëshpallur nga shqiptarët në Kosovë", ka thënë ai.

Si politika zyrtare e Serbisë, ashtu edhe ajo e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (ASHAS) i kanë vënë vetes qëllim "mbrojtjen e interesave të popullit serb në rajon, i cili ishte dhe është imperativ politik, historik dhe moral", shprehën Ivica Daçiq e Vuk Jeremiç, të cilët shpeshherë do të deklaronin se "është normale që prioritet për ne janë pozitat e serbëve në rajon...". Në këtë linjë, në mënyrë të programuar janë shprehur edhe akademikët Dobrica Qosiq e Lubomir Tadiç, të cilët përgatitën Memorandumin 2 (2011), të ASHAS, i cili, për dallim me Memorandumin e vitit 1986, është dokument konfidencial, i cili u është dërguar anëtarëve të kabinetit qeverisës për lexim, por "pa shpërndarje të mëtejshme".

Në përgjithësi pikëpamjet e akademikëve aktualë serbë për Kosovën, të publikuara deri më tash në mediat serbe, nuk dallojnë nga ato që ishin shprehur në memorandumun e kësaj akademie në fund të viteve '80, të cilat i kanë nxitur aspiratat ekspansioniste të Serbisë dhe kanë çuar në luftëra të përgjakshme midis Serbisë dhe njësive të tjera të federatës së ish-Jugosllavisë, e posaçërisht në Kosovë. Kohët e fundit, në

Në Burgun e Sigurisë së Lartë gjenden substanca narkotike

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se në Burgun e Sigurisë së Lartë, zyrtari korrektues R. J. me detyrë në Portën 0 është ndalur nga zyrtarët e tjerë me detyrë në të njëjtin vend, të cilit i kanë gjetur substancë të dyshuar narkotike. R. J. i është bërë kontrolli trupor, ku në xhep i është gjetur edhe një paketim me

32 letra për mbështjellje të marijuanës. Lidhur me rastin menjëherë janë njoftuar prokuroria dhe policia, të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes, fillimisht Policia e Stacionit të Podujevës, po ashtu edhe zyrtarë policorë të Njësitit Antidrogë nga Regjioni i Prishtinës. Me urdhër të prokurorit, R. J. është arrestuar dhe është

dërguar në stacion për intervistim. Ndaj të njëjtit, ShKK-ja ka iniciuar procedurat për pezullim nga vendi i punës. Shërbimi Korrektues i Kosovës është i fokusuar në luftimin e dukurive negative, ku hyjnë luftimi i kontrabandës dhe substancave narkotike, keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe korrupsioni.



Akademikë Serbe të Shkencave dhe Arteve ka edhe anëtarë që kanë pikëpamje më të avancuara lidhur me çështjen e Kosovës. Një ndër ta është edhe kryetari i kësaj akademie, Vladimir Kostiq, i cili vlerëson se Serbia e ka humbur Kosovën dhe lidhshipin politik dhe opinionin serb duhet ta kuptojë këtë. Për shkak të këtyre pikëpamjeve, Kostiq ka qenë në shënjestër të sulmeve brenda dhe jashtë Akademisë, sidomos të udhëheqjes shtetërore të Serbisë. Latinka Perović, akademike serbe, ka ngritur zërin kritik për instrumentalizimin politik të akademikëve në Serbi. “Në vend se politikanët të mësojnë nga njerëzit e dijes, thotë ajo për politikanët serbë, ata i thërrasin për dëgjueshmëri”. Ndër zërat e pavarur dhe të përgjegjshëm ka qenë edhe akademik Vladimir Kostiq, që ka ngritur zërin për domosdoshmërinë që akademikët të mbesin jashtë politikës, me qëllim që të mund të jenë politikisht të paanshëm. Por, këta zëra të vetmuar dhe të izoluar në mjediset akademike serbe nuk e thyjnë dot mjedisin e fuqishëm dhe të indoktrinuar nacional-shovinist të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë.

3. Diplomacia perëndimore, pa ndikim mbi Kishën dhe Akademinë Serbe

Një nga arsyt që procesi diplomatik perëndimor me Serbinë po vërtitet në një rreth të mbyllur pa rrugëdalje, është pikërisht për faktin se diplomacia perëndimore është fokusuar te lidhshipi politik e diplomatik serb, ndërkohë që ky i fundit është i kryqëzuar midis Kishës dhe Akademisë Serbe. Perëndimi dhe diplomacia e tij nuk depërton dot fare në kishën serbe, ndërkohë që ka fare pak ndikim mbi individë të veçantë të Akademisë Serbe. Në Perëndim, shteti, politika dhe diplomacia janë të ndara prej shprehjes nga feja, doktrina e institucionet e saj. Ky refuzim i Perëndimit e bën të pamundur që politika dhe diplomacia e tij të mund të depërtojnë e aq më pak të ndikojnë mbi kishën serbe. Ndërkohë, kisha serbe vijon edhe fare hapur të ndërhyjë mbi politikën jo vetëm në Serbi ku bën ligjin, por edhe në Maqedoninë e Veriut, edhe në Mal të Zi, edhe në Kosovë.

I vetmi mekanizëm që do të mund ta vinte disi në lëvizje

kishën serbe është Rusia, si shteti ashtu edhe kisha ruse. Mirëpo Rusia kishën dhe rolin e saj në gjeopolitikë e ka gjë të shenjtë. I betuar përpara Kushtetutës si dhe Biblës dhe patriarkut të kishës ruse, presidenti Putin e ka kishën ‘as’ nën mëngë, për situata kur politika e diplomacia e tij nuk do të mund të funksionin siç duhej. Kisha Ruse është më e përlulur ndaj Kremlinit, kjo edhe për faktin se sistemi stalinist e gjuhëzoi kishën ruse për një kohë të gjatë përballë ateizmit komunist. Ndërsa kisha serbe është më e fuqishme ndaj politikës serbe, sepse askush, në asnjë sistem dhe në asnjë kohë nuk ia ka cenuar sadopak pushtetin mbi të. Ndërkohë, kisha ruse vijon të ruajë autoritet të lartë mbi kishën serbe dhe mund të ndikojë mbi të. Pra, që Perëndimi ta rrisë efikasitetin e tij politiko-diplomatik mbi Serbinë duhet ta rrisë ndikimin mbi kishën serbe. Për ta arritur këtë, Perëndimit i duhet ta sigurojë rolin ndikues të kishës ruse. Mirëpo kjo e fundit mund të vihet në lëvizje vetëm nga politika dhe diplomacia ruse, pra nga Putini.

Në ditët tona po krijohet përshtypja se diplomacia perëndimore, ShBA-ja dhe BE-ja, po lëvizin drejt trajktoreve Serbi - Kosovë, për të shkuar drejt një marrëveshje të shumëpritur por, në të vërtetë, mjaft larg për t’u arritur. Edhe Kosova po lëviz në mënyrën e saj, ndonëse jo krejt e qartë dhe kohezive. Krahu më i ngurtë, që nuk po lëviz fare nga pozicioni i saj është Serbia, e mbështetur në mënyrën e vet nga Rusia. Ndodhemi pra, në një aksion diplomatik asimetrik: Perëndimi po nxiton, Kosova po lëviz, ndërsa Rusia po frenon, Serbia po bllokton. Politika dhe diplomacia serbe janë të kryqëzuara midis kishës dhe Akademisë së Shkencave. Ndërkohë, politika dhe diplomacia perëndimore po punojnë vetëm me politikën dhe diplomacinë serbe, që janë faktorët më të paafte dhe më të pafuqishëm, së paku tani për tani, për ta ndryshuar kursin zyrtar të politikës serbe, pa dakordësimin dhe mbështetjen e Kishës dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Se sa kohë do të vërtiten politika dhe diplomacia perëndimore në këtë trekëndësh të mbyllur serb... kjo ngelet për t’u parë... natyrisht për një kohë jo shpejt...

Naim Fetahu, kandidat i PDK-së për kryetar të Podujevës

PODUJEVË, 17 SHKURT (ER) - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Podujevë, Naim Fetahu, do të jetë kandidat i kësaj partie për kryetar të komunës, e cila deri më tani është drejtuar nga Agim Veliu.

Fetahu ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës në të kaluarën.

Në garë për të parin e Komunës së Podujevës janë edhe Nexhmi Rudari nga LDK-ja dhe Shpejtim Bulliqi nga Lëvizja Vetëvendosje.


Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës do të



mbahen më 15 mars, pasi Agim Veliu ka dhënë dorëheqje nga pozita e të parit të kësaj komune sapo është bërë ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë Kurti.

Vendimmarrja e MMPH-së sfidon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren

PRIZREN, 17 SHKURT (ER) - “Kërkesa e vazhdueshme e ‘EC Ma Ndryshe’ për unifikimin e veprimeve të institucioneve lokale dhe atyre qendrore për zbatim të ligjit dhe rend urbanistik në Prizren vazhdon që të shpërfilllet nga autoritetet përkatëse”, është bërë me dije në një reagim të “EC Ma Ndryshe”. Sipas këtij reagimi, praktika e moskoordinimit ndër-institucional, sikurse edhe mosunifikimi i procedurave mes tyre, po krijon rrethana të pafavorshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në këtë qytet. “Komuna e Prizrenit më 13 shkurt 2020 ka publikuar informatën për publikun lidhur me projektin e kompleksit afarist-banesor në ish-Fabrikën e Farmakosit, ku në afërsi ditë më parë është djegur ‘Ndërtesa Austriake’. Komuna ka njoftuar se pas vendimmarrjes së MKRS-së, DUPH-ja më 22.11.2019 kishte refuzuar kërkesën e investitorit për ndërtimin e objektit disakatësh, derisa MMPH-ja më 10.01.2020 merr vendim që ta shpallë të paligjshëm aktvendimin e Drejtorisë. ‘Djegia e ndërtesës në



lokacionin ku parashihet ky projekt nuk e ndryshon qëndrimin e komunës dhe në vijim do të shikohen mundësitë ligjore që të kundërshtohet vendimi i MMPH-së”, thuhet në njoftimin e Komunës.

“EC Ma Ndryshe” ka theksuar se një praktikë e ngjashme ka ndodhur edhe me kërkesën e një investitori tjetër për ndërtimin e objektit për banim kolektiv në rrugën “Rifat Krasniqi” në Prizren. “EC Ma Ndryshe” përkujton se disa herë ka bërë thirrje publike që institucionet e nivelit lokal dhe qendror t’i unifikojnë veprimet për zbatim të ligjit dhe rend urbanistik në

Prizren. Prandaj EC-i përsëri i bën thirrje Komunës së Prizrenit, si dhe ministrive përkatëse në Qeverinë e re të Kosovës, që të ndërmarrin nisma për bashkërendimin e veprimeve me qëllim të vënies së rregullit urbanistik dhe zbatimit të tërë legjislacionit në fuqi, pa e veçuar vetëm një ligj të caktuar. Të dyja nivelet e qeverisjes duhet të bëjnë përpjekje për respektimin e legjislacionit në tërësi, unifikimin e procedurave dhe koordinim më të mirë, me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe interesit publik në Prizren”, është thënë në reagimin e EC-it.

RrGK-ja bën nderime te varri i Nexhmije Pagarushës për 17 shkurt

Malishevë, 17 shkurt (ER) - Anëtarët e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) të hënë, me rastin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë bërë homazhe te varri i ikonës kosovare Nexhmije Pagarusha (1933-2020). Në shenjë nderimi dhe respekti për jetën dhe veprën e Pagarushës, si një grua e fuqishme, anëtarët e

RrGK-së vendosën lule te varri i saj në fshatin Pagarushë. Në vitin 2015 RrGK-ja për Pagarushën ndau mirënjohje për “Guximin dhe veprat të cilat kanë motivuar dhe fuqizuar vajzat dhe gratë në Kosovë”. Vepra e saj mbetet frymëzuese sot e përgjithmonë.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SKENDERAJ



12 VJET PAVARËSI
12 YEARS INDEPENDENCE
12 GODINA NEZAVISNOSTI



*Të rënë në altarin e pavdekësisë, sollën Lirinë e Pavarësinë.
Në jetësjmë amanetin e tyre, duke zhvilluar shtetin!*

KRYETARI I KOMUNËS:

Bekim Fashari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

MINISTRIA E EKONOMISË, PUNËSIMIT, TREGTISË, INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE INVESTIMEVE STRATEGHIKE
MINISTARSTVO EKONOMIJE, ZAPOŠLLAVANJA, TRGOVINE, INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I STRATEŠKIH INVESTICIA
MINISTRY OF ECONOMY, EMPLOYMENT, TRADE, INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND STRATEGIC INVESTMENTS

URJME KOSOVË
12 VJET SHTET



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA_{ERE}



**URIME PAVARËSIA
KOSOVË
12 VJET SHTET**

MKRS-ja dha çmimet për letërsi

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për nder të 12-vjetorit të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sot ka dhënë Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe çmimet vjetore për letërsi.

Juria profesionale për vlerësimin e çmimeve në përbërje të prof. dr. Hysen Matoshi - kryetar, Adem Zejnullahu, Faik Shkodra, Emin Emiri dhe Riza Haziri - anëtarë, kanë vendosur që çmimet të jepen për: Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" t'i jepet Sabile Keçmezi - Basha; Çmimi për veprën më të mirë në prozë "Anton Pashku" t'u jepet Rrahman Paçarizit për romanin "Shtatë udhë" dhe Albina Idrizit për romanin "Përsëri mars"; Çmimi për veprën më të mirë në poezi "Ali Podrimja" t'u jepet Xhevdet Bajrajt për veprën "Kur qajnë hardhitë" dhe Nexhat Rexhës për veprën "Duke kërkuar hijen tënde"; Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistikë "Ibrahim Rugova" t'i jepet Berat Dakajt (Armagedoni) për



Dumoshi.

Duke filluar nga procedurat e hapjes së konkursit e deri te ndarja e çmimeve parashihen me rregullore të veçantë të MKRS-së, e cila procedurë përfshin dhe emërimin e një jurie, e cila rekomandon laureatët e çmimeve.

"Unë si ministre e vlerësoj lart dhënien e çmimeve për letërsi, sepse besoj se duke dhënë këto çmime për çdo vit ne i kontribuojmë edhe stimulimit dhe nxitjes së krijesve të

motivacionin për punën e saj krijuese në fushën e letërsisë, për një varg veprash që shquhen për prurje të reja si në përmbajtje ideore, po ashtu edhe në format letrare.

Ndërsa për çmimet e tjera juria dha këto vlerësime: Proza "Shtatë udhë" e autorit Rrahman Paçarizi ta kujton rrëfimin biblik për krijimin e botës e të njeriut brenda një jave. Romani "Përsëri mars" i Albina Idrizit ngërthen vlera ideore, estetike dhe artistike; elemente të bollshme realiste, aktuale, madje historike. Përmbledhja poetike "Kur qajnë hardhitë" e Xhevdet Bajrajt shquhet për intonacionin e veçantë ligjërimor e estetik, për krijimin e kodeve dhe figurave poetike me një emancipim të thellë mendimor e emocional. Përmbledhja poetike "Duke kërkuar hijen tënde" e Nexhat Rexhës shpërfaq dramën e individit si reagim artistik përballë bëmave të historisë dhe të aktualitetit. Studimi monografik "Dramat e Qosjes" i Berat Dakajt (Armagedonit) ngërthen një shumësi elementesh dhe premisash të zhvillimit të dramës shqipe në kontestin historik, teoriko-letrar, ideoestetik, filozofik, antropologjik, mitologjik e socio-psikologjik. Romani autobiografik "Guaska" i Mustafa Halifas, shkrimtar sirian, është një ndër veprat lapidare që, nëpërmjet një rrëfimi të çlirët, përshkruan dhunën dhe brutalitetin e pushteteve, rrjedhojat që ia krijojnë individit të qëndruarit brenda guaskës kufizuese. Tregimet e vëllimit "Libri i përrallave të gjyshit" të Jonuz Fetahajt përshkohen me ngjarje që trajtojnë botën e brendshme të fëmijëve, dëshirat, ëndrrat, mendimet mbi jetën dhe për jetën.



studimin "Dramat e Qosjes"; Çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas "Pjetër Bogdani" t'i jepet Isa Memishit për përkthimin e romanit "Guaska" të Mustafa Halifas; dhe Çmimi për veprën më të mirë për fëmijë e të rinj "Vehbi Kikaj" t'i jepet Januz Fetahajt për veprën "Libri i përrallave të gjyshit".

Me këtë rast, në një ceremoni të organizuar në kabinetin e ministres Vlora Dumoshi, e para e MKRS-së u uroi mirëseardhje laureatëve dhe anëtarëve të jurisë.

"Në këtë ditë të shënuar kujtojmë të gjithë ata krijues që me veprat e tyre kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në krijimtarinë tonë. Jo rastësisht ndarja e çmimeve të letërsisë po bëhet sot në këtë ceremoni të organizuar nga ministria sepse, përveçse po ndajmë çmime të rëndësishme për letërsinë, kulturën dhe artin, përveçse sot po i shpërblejmë krijuesit e letërsisë, po e festojmë edhe përvjetorin e shtetësisë së Kosovës. Sot simbolikisht më takoi mua si ministre që t'i ndaj këto çmime, ndonëse të gjitha punët rreth vlerësimit të tyre i takojnë mandatit të qeverisjes së kaluar", tha ministrja

shkruajnë, të krijojnë dhe ta pasurojnë artin e fjalës sonë të shkruar", u shpreh ministrja, duke rikonfirmuar se mbetet e përkushtuar të punojë shumë në mbështetjen e të gjitha fushave të kulturës dhe të artit, të krijesve dhe performuesve për ta avancuar kulturën e Kosovës dhe për ta promovuar vendin.

Kryetari i komisionit vlerësues, Hysen Matoshi, konfirmoi se vlerësimi i jurisë për ndarjen e Çmimit "Azem Shkreli" autores Sabile Keçmezi - Basha është dhënë me



EVROPË!, UNË E KAM FLAMURIN!

Ylli MECE

*I shtrëngova duart grusht
Dhëmbët theva prej inatit
Se jam bir i kësaj toke
Kosovar që s'pret prej fatit*

*Nëse unë e kam flamurin
Pse në shtizë vure një tjetër?
Do t'më thuash se lirinë
Ti ma fale "zuskë e vjetër"?!!*

*Unë nder shekuj vrullshëm renda
Për At dhe...e për flamur
Bota hiq...se nuk e dashka...
Ata hiq.... e ne prapë vur!*

*Ky flamur më duket ndryshe
Nuk më duhet jo për besë!
Se pa drite ...çdo lule vyshket
Pa një zemër...çdo komb vdes!*

*Si se njohe kurrë shqiptarin...?
Moj Evropë ...që rri mbi letër!
Ne Lirinë edhe Flamurin...
Nuk e ndërrojmë me asgjë tjetër!*

*Nëse fale një flamur
Dhe e morën pa e parë
Sytë vallë ku i kishin?
Se me gjak ky s'është i larë!*

*Ah moj kohë e padrejtësive
Si me vjen kështu maskuar
Pse ma ndan më dysh flamurin
E pse më bën të rebeluar?*

*A e di ti moj Evropë
Se flamurin kam At dhe?
Nëse ti ma heq shqiponjën
Kot që rrojmë, përmbi dhe!*

*Po të them: Mos më godit!
Mos godit mbi gjak të rënë
Padrejtësive shekullore
Pse u shton një më të rendë?*

*Këtë "dhuratë" unë nuk ta dua
Është turp, turp për besë
Unë e kam në shpirtin tim
Dhe në zemër do të mbesë!*

*Ndaj dhe zemra me rreh fort
Gjakun që kalon në rremba
Nuk ma ndal dot as me plumb
Nuk ma lidh as tel me gjemba!*

*Ne shqiptarët që prej motit.
Pak i pamë lulet e fushës
S'na la tymi i barotit
Nuk na lanë erërat e luftës.....!*





Poezi nga Emine
MALIQI-ZAIRI

Edhe unë

Edhe unë kam vvarë dikur
dy trumcakë me një gur
ishin ato kohë të tjera
s'vinte vdekja por kolera
edhe unë kam dashtë dikur
një njeri që dukej burrë
ishte kjo në krye të herës
dashuri në kohë t'kolerës
por atij nuk i thashë kurrë
koha ishte të gjithë vrisnim
më pas uleshim i qanim
prej atëherë s'kam vvarë më kurrë
as trumcakë e as burrë
për veten ruajta një gurë

Dimni a dergjë

Rrikan kapun lisit
do fleta t'thame
si dëshirat e mrame
që thuhet pak para dekës
kishin kujtu që janë zogj
e fluturojnë njonja mas tjetrës
se kishin ditë
se dimni a dergjë
a dhimtë

Mesditë asht

Malin breshni kurrë s'e ka rrxu
as ti mu
arën gruni kurrë s'e ka ngi
as unë ty
jemi sall dy duj
t'lidhun tek e tek
prej lyfyrave egra
rritun nji moti t'lig
dokemi s'i miq
e s'jemi hiç
mesditë asht
veçse dita ka nis me u zgjatë sa dy
net
dielli me u dok ma shpesh
e na ma rrallë
nermjet e kemi ma shumë se i prill
ma shumë se i trill
jemi dy duj t'keq
që dergjen veç e veç

Përbrenda

Dje zbraza xhepat e kapotës
nga iluzionet
sot ajo s'kishte më
as mëngë për qafimi
eleganca e saj varej në penj të hollë
as kopsat s'i bënë punë
të mërtheja me to së paku një poezi

më parë s'e kisha idenë
sa ngrohtë e mbanin iluzionet
astarin e kapotës
mua përbrenda
bashkë me dimrat e mi

N'prehër nji stine

Ra borë
fëmijëria ime rrëshqiti teposhtë
mbi një prehër saji
shkrihem si dordolec
kur kujtohem
në të bardhen e moshës sate
sa mirë i rrinte
dimrit tim

Deri n'vjeshtë

M'thojke
ej thanukël çilu e para
qata t'kom mjell
n'ballë t'shpatit tem
me t'i vjel
kokrrat e kuqe gjatoshe
me t'deshhtë deri n'vjeshtë
m'ka ftu
me u mush push
n'mjesdis lulave t'bardhme
me u zverdhë
s'i f'tyrë e paardhme
ni qilerë me ngi erë

Valixhe andrrash t'vogla

Gishti i dëshirës
Pres biletë udhëtimi
ma shpesh se rroba t'reja dikur
dhe kujtohem
në kohën e petkave t'vjetra
mbi trup t'ri
kundrave sevdalike gojëshqyer
valixhen me andërra t'vogla
mbërthyer
edhe në kafën e lehtë kujtohem
që s'linte gjurmë në filxhan
as fati i rrugëve s'lexohej kjartë
edhe pse udhëtimet
bëheshin pa hartë
pres biletë udhëtimi
por asnjë fytyrë e njohur rrugën s'ma
pret
dikur kisha njohur gati një qytet
tashmë llumi i kafes tepron në fund
të filxhanit
por gishti i dëshirës
s'është më i njëjtë

Zani i kujtesës

Hiç s'osht ma shumë
se nji ditë e avashtë
kur pritej prej ftoit
me ngi me erë
nji arkë me petka
poçit t'mjaltës i lypej
me na ngi neve
me nga ni lugë
asht veç ni ditë
qe zgatë
kur kukulla e drunjte
ushtrijke durimin para kallit
t'mistrin
me u bo me flokë
s'osht moti kur hanës s'iu dashke
me i kallxu t'dy faqet

se te ton' flejshim me ni odë
duar t'vogla ka shiu
por nuk arrinë t'ma lajë kujtesën

Ah-o

Ah-o m'tradhtove
kur dojshin me t'pre për dru
kur t'ikën zojtë
kur t'zhveshi era
kërkush kërkuj
mbi ty e majta shikimin
gati sa retina m'u dogj
Ti për hatër t'ni tjetër stine
i mbushe rremat zogj
kemi mujtë me u nda krejt ndryshe
nji krah t'ma rujshe
për pëllumbat e kujtesës
të tjerët për dallëndyshe
hej ke pas boll ven
me ni rreth trungu
edhe për flugin e zemrës tem

N'mu

Mirë që s'banon
me mu
se unë do t'përlahesha me gotën që
ti pi
se ajo ta preku cepin e buzës
do të zihesha me briskun e rrauzës
që ta përshkon arrën e gushës
mënia jeme do t'dokej fushës
Hej dije
edhe pemtë e kopshtit do t'i preja
mos me t'zatet me hije
as me pikat e shiut
n'ujdi s'do t'bija
që ranë mbi t'prekmet e mia
për orët që do t'mungojë

do ta rrisja qiranë
me mjekët në rast se sëmuhesh
do ta ndezja belanë
edhe për majthat e gishtave
me rezen e derës
me t'shejtin shpend t'verës
që t'kapërcej pa m'vetë mu
me krejt isha idhnu
dhe për inat
me ton ata që besojnë n'zot
do t'boja shamatë
se nën kulmin tem
puthem me perëndinë
ditë e natë
ngo ti zemra jeme
mirë që s'banon me mu
po n'mu

T'kom vizatu

Dje t'vizatova
mirë dole
kamtë me të njejtën gjatësi
ashtu edhe krahtë
f'tyrës mangu nji vijë
dokesh ma i ri
n't'kapshin
dënohesh ma pak
n'vrafshin t'kaj ma gatë
dje t'vizatova mi borë
sot mbete veç vijë
prej ktu
e deri ku ma s'kapet
as me sy
as me dorë
as kur des
as kur t'plaket
edhe për nesër e di
qe s'muj t'za
as me za

TI MBRËTËRESHA E KËNGËS SHQIPE

(Bilbilit të Shqiptarisë, Nexhmije Pagarushës)

O mbretëreshë e këngës në Shqiptari
Na dhe dashuri e gjokset na ngrohe
O bilbil Kosove na dhe në vite ëmbëlsi
Me këngët e pentagramet e tua hyjnore.

Me tingujt e tu do të zgjohemi në mëngjes
Do të shohim bukuri natyre rrethuar me zell
E qengji i vogël do të blegërojë në livadhin e blertë
Po bareshën tënde do të kemi këtu mes nesh.

Do të bien tupanët e vallja nuk ndalet mes fushe
Edhe dallëndyshet na sillen përreth
Moj bukuroshe që vjen prej Pagarushe
Ti ishe vetë zambaku i çelur në Prizren.

Oj kosovarja e bukur, o syri i dritës
Je një lule në eposin tonë plot kujtime
Je vetë engjëlli i shenjtë i notës së muzikës
I kulturës tonë të lashtë që vjen mes tradite.

Për zërin tënd të ëmbël sot filloi vajin violina
Do të pret mbi oxhak një sharki, një çifteli
Në lotin tonë do të ndrijnë edhe më shumë drita
Përherë do të dëgjojmë madhështore, Loke nderimi.

Ajet Shala "Ajhasha"



Leximi në epokën e shpërqendrimit të pareshtur

Nga Mairead SMALL STAID

“Lexoj libra për të lexuar veten”, shkroi Sven Birkerts në “Elegji për Gutenbergun: fati i leximit në një epokë elektronike”. Libri i tij, i cili sivjet mbush njëzet e pesë vjet që është botuar, përbëhet nga pesë mbëdhjetë ese për leximin, veten, pikëtakimin e tyre, dhe mënyrat se si të dyja kërcënohen nga depërtimi i teknologjisë moderne. Ndërsa kultura rreth tij pësoi ndryshimin e skajshëm që solli interneti, Birkerts-i pati frikë se cilësitë e mbrojtura dhe të vlerësuara për një kohë të gjatë të librit të shtypur kishte rrezik që dalëngadalë të zhdukeshin: ndërto, privatësia, vlerësimi i vetëdijes individuale dhe vetëdija për historinë, jo thjesht për faktet e saj, por ndjenjën e vazhdimësisë së vendit tonë gjatë shekujve dhe në kozmos. “Letërsia ka kuptim jo si përmbajtje që mund të shkëputet dhe përmbledhet, por si përvojë”, shkroi ai. “Ajo është arenë pjesëmarrëse. Përmes procesit të leximit, ne shmangim orientimin e zakonshëm në lidhje me kohën, i cili karakterizohet nga shpërqendrimi dhe sipërfaqësorja, për të dalë në

mbretërinë e të përhershmes”.

Duke shkruar në 1994, Birkerts-i ishte i shqetësuar që shpërqendrimi dhe sipërfaqësorja do të fitonin. “Gjendja e të përhershmes” që përjetojmë në një faqeje libri do të humbas në një botë ku shpejtësia dhe fijet ndërlidhëse të saj rriten në mënyrë të pamëshirshme, dhe me bashkë me do të humbas edhe aftësia jonë për t’u dhënë kuptim rrëfimeve, si atyre të trilluara ashtu edhe atyre jetësore. Rrudhja e letërsisë, e leximit të përhershëm, e shkrimit si produkt i një mendjeje të vetme të përqendruar, do ta rrudhte ne, duke na bërë gjithnjë e më pak të aftë të rrokim gjerësinë e botës dhe po kështu thellësinë e vetëdijes tonë individuale. Për Birkerts-in, ashtu si për shumë lexues, të menduarit e një humbje të tillë është rrënues. Ndërsa munda ta përfytyronte këtë të ardhme të errët, të afërt, ai (më së shumti) i rezistoi shtysës mazokiste për ta parashikuar më konkretisht se duhet, duke u përqendruar tek e tashmja, ku, për një kohë më gjatë, ai të paktën lexon, dhe shkruan. Përmbledhja e tij me ese për leximin, pavarësisht nga titulli,

nuk ngjan edhe aq me elegji për letërsinë se sa me një përpjekje për ta ndaluar vdekjen e saj duke shkruar në mënyrë bindëse për jetën e tij kushtuar leximit dhe qëndresën ndaj ndikimit shpërqendruar të elektronikës. Birkerts-i na kujton se një jetë e tillë ka vlerë, ke dëshirë ta jetosh dhe çfarë është më e rëndësishmja, është akoma e mundur. Përballë asaj që po humbasim, ai dëshmon për atë që akoma mund të fitojmë. Një çerek shekulli më vonë, a arriti ai, a arritëm ne të shpëtonim çfarë mund të shpëtohej? Apo frika më e madhe që kishte Birkerts-i është tejkaluar? Është e vështirë të thuash nëse shohim numrat. Numri i librarive të pavarura që po hapen është më i madh se i atyre që mbyllen, dhe shitjet e librave të shtypur janë në rritje, por fitimet e autorëve janë në rënie. Më pak amerikanë se dikur lexojnë për kënaqësi. Një shtëpie e madhe botuese u mbyll kohët e fundit, ndërsa aplikacioni me rrëfime të instaluar “Wattpad” njoftoi objektivin për të botuar libra të zgjedhur nga algoritmet, pa pasur nevojë për redaktor. Disa nga ndryshimet që Birkerts-i pa të shfaqeshin në horizont –

shpikja e librave elektronik dhe mundësitë e hipertekstit dolën të jenë më pak të rëndësishme se sa ishte parashikuar, por ndryshimet e tjera janë më të këqija si për shembull, shpërqendrimi tejet i shpeshtë dhe varësia nga ekrani që gllabëron orët tona. Ndoshta rreziku më i madh për letërsinë s’është asnjë nga këto shpikjet e reja teknologjike apo përditësimet e tyre të zhurshme, por thjesht lakmia e lashtë njerëzore në versionin e saj më të fundit dhe më të madh që një shitës librash me pakicë në internet shfaqti në të njëjtin vit që u botua “Elegji për Gutenbergun”. Gjatë njëzet e pesë vjetëve e fundit, Amazon ka treguar babëzi për gjërat e lehta dhe që kushtojnë lirë, këto vlera të kapitalizmit, duke kërcënuar se do të monopolizoj jo vetëm botën e librave, por edhe botën në tërësi. Përballë një kërcënimi kaq tinzar, gllabërues – jo thjesht ky gjigand i teknologjisë, por kultura që ai krijon dhe mbështet ma bën të vështirë ta shkëpus frikën për të ardhmen e librave nga frika për të ardhmen e ekonomive të qytezave, për demokracinë amerikane, për tokën dhe ngritjen e nivelit të

detrave.

“Dhjetë, pesëmbëdhjetë vjet më pas, bota s’do të jetë fare siç e mbajmë mend, asgjë s’do të jetë si tani”, shkroi Birkerts-i. “Do të notojmë në impulse dhe të dhëna, mikroçipi do të na bëjë oferta që do të jenë shumë të vështira për t’u refuzuar”. Në të vërtetë, pak prej nesh nuk i kanë pranuar. Ndërsa çdo teknologji e re, që nga smartfon-at deri tek pajisjet ndihmëse shtëpiake që aktivizohen me zë, bëhet pjesë normale e jetës së përfutshme, shumë shpejt, aftësia jonë për ta refuzuar zvogëlohet. Zgjedhja e paraqitur në “Elegji për Gutenbergun”, midis pranimit dhe skepticizmit, vështirë se duket më si një zgjedhje: brezi i ri tani lind i mbështjellë me krahët e shumë të botës digjitale. Unë jam dhe nuk jam pjesë e këtij brezi të ri. U linda në 1988, dy vjet para zhvillimit të sistemit të strukturimit dhe formatimit të dokumenteve në internet. Nuk kam pasur kompjuter në shtëpi deri në shkollën e mesme, as celular derisa mbusha tetëmbëdhjetë vjeç. Më kujtohet kur merrja në telefon me aparatura tradicionale dhe mbaja vesh për piip-in e dhimbshëm, të mezidëgjueshëm. Facebook-u

u përhap kur mbarova shkollën e mesme ndërsa Twitter-i kur hyra në kolegji. Orët e arta të fëmijërisë përputhen në mënyrë të përkryer me dritën e venitur të një bote të para-internetit. Thellë brenda meje e di që një botë e tillë ka ekzistuar dhe kishte përparësitë e saj.

Birkerts-i, duke kujtuar pushtetin që kishin librat tek ai kur ishte i ri, shkruan: “Përmes leximit dhe të jetuarit unë dalëngadalë u khteve në një provë e magjepsjes të plotë pas autorëve të librave. Sidoqoftë, kaq të gjalla janë kujtimet e mia për atë shtysë të fuqishme leximi, për atë ndjenjë përjetimi, saqë vazhdoj të kërkoj ta përjetoj edhe sot”. Gjendja shpirtërore që krijohet nga një libër, ajo gjendje në të cilën ti je “i pranishëm në mënyrë aktive në çdo çast, ndërsa lexon atë që është shkruar duke e rikrijuar gjatë leximit”, është ajo që kërkojnë lexuesit, argumenton Birkerts-i: “Ata duan subjekt dhe personazh, natyrisht, por ajo që në të vërtetë duan është një mjet që i kalon në gjendjen e leximit. Kjo gjendje kërcënohet nga interneti gjithëpërhapës. A mundet që premtimi i librit për prani të thellë të na largoj nga kënaqësia e menjëhershme e “pëlqimeve” dhe “shpërndarjeve”?

“Puna me vite në librari më ka bindur se kjo gjendje themelore krijohet edhe për të tjerët”, shkruan Birkerts-i. Kur ishte i ri, ai punoi për një librari të quajtur “Borders”, pjesë e rrjetit asokohe të pvarur të librarive “Ann Arbor”. Pas katër dekadash, tërhoqa libra nga libraria “Literati Bookstore”, në qendër të Ann Arbor-it, Michigan, pak blloqe banesash më tutje nga ku banoja unë. Raftet e librarisë së dikurshme “Borders” ishin blerë dhe përshtatur nga pronarët në këndin e librave letrar, ndërsa klientët që i shfletonin ishin po ato, sepse librat ishin renditur si më parë dhe ishin po ato tituj, dhe u jepnin po atë ndjesi kur i merrnin në dorë për të shfletuar faqet e para.

Dhe nëse klientët donin libra të modeluar sipas internetit, libra dhuratë të rrjeteve sociale Tumblr, Instagram, ata i shtypnin dhe lidhnin. Kërkohej libri “Agulçet” i Maggie Nelson-it, “Qyteti i hapur” i Teju Cole, “Cari i dashurisë dhe teknologjisë” i Anthony Marra, “Mos lejo të jem i vetmuar” i Claudia Rankine-s. Vetmia është ajo që interneti dhe rrjetet sociale mëtojnë ta luftojnë, megjithëse shpesh kanë efektin e kundërt. Lidhja shpirtërore është e vështirë për t’u krijuar, jo sepse ne s’jemi në të njëjtën hapësirë fizike por sepse s’jemi në të njëjtën rrafsh mendor: s’lexojmë të njëjtin lajm; madje as nuk argëtohem nga e njëjta meme. Telefonat dhe kompjuterët i japin secilit prej nesh një variant të personalizuar, ose më saktë, të kryer sipas algoritmeve të titujve, anekdotave, shakave dhe fotografive. Madje edhe reklamat

që na kalojnë para syve s’janë të njëjta me ato që shohin fqinjët tanë: një palë çizme më kanë dalë para sysh në faqe të ndryshme interneti për javë të tëra. Ne e quajmë këtë material të pafund, jolëndor, një ushqim, ku zor se gjen ndopak vlera ushqyese.

Argumenti i Birkerts-it (dhe i imi) nuk është se librat e luftojnë vetminë. Të mëtossh se çdo aplikacion dhe faqe internet këtë synon, do të thotë ta humbasësh luftën për letërsinë para se të filloj. Jo, fuqia e artit (dhe shumë libra vazhdojnë të jenë ende art, jo argëtim) qëndron në mënyrën se si na bën të shohim në të njëjtën kohë botën brenda dhe jashtë nesh. Lidhja shpirtërore që kërkojmë, marrja në duar e librave ose shfletimi i faqeve, s’do të thotë se jemi me të tjerët, madje as me me të gjallët e as me të vdekurit qëkuri, të cilët shkruan çfarë po lexojmë, por se jemi me veten tonë. Aftësinë tonë më të mirë, aftësinë e jashtëzakonshme që kemi për të dialoguar me veten, priremi ta harrojmë shumë shpejt.

Në fillim të “Elegji për Gutenbergun”, Birkerts-i përmbledh përkufizimin e historianit Rolf Engelsing për leximin “e thellë” si praktikë e zakonshme e shumicës së lexuesve para shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur librat, të cilët ishin të paktë dhe të shtrenjtë, shpesh lexoheshin me zë të lartë dhe disa herë. Ndërkohë që u përhapën në mënyrë masive materialet e leximit, jo vetëm librat, por edhe

gazetat, revistat dhe biografite, gjatë shekujve të fundit u vu re përhapja gjithashtu e leximit “të shpejtë”. I lexojmë këto materiale një herë, shpesh e shpejt, dhe kaq. Birkerts-i krijon terminologjinë e tij: praktika e thellë, e devotshme e leximit “vertikal” është zëvendësuar nga leximi “horizontal”, i cili cek sipërfaqen. Kjo zhvendosje është përshpejtuar marramendshëm që nga koha kur shkroi Engelsing-u në 1974, qëkur shkroi Birkerts-i në 1994, dhe qëkur unë shkrova dje, paragrafin më lart.

Leximi horizontal sundon gjatë gjithë ditës. Ajo që bëj kur shoh çfarë shkruhet në “Twitter” është më pak e ngjashme me leximin e një libri se sa me leximin e udhëzimeve të një recete ose me shifrat e shndritshme të një fature: më japin informacione, nuk më ndriçojnë për ndonjë gjë. Është një mënyrë për të kaluar kohën, jo për të jetuar. Leximi, leximi i vërtetë, ai lloj leximi për të cilin Birkerts-i është mbrojtës i flaktë – mbështetet tek ndjeshmëria jonë vertikale, sado e fshehtë, dhe “kur nuk gjen thellësi, e krijon atë”.

Nuk kam më adresë në Facebook, dhe shoh se po harxhoj gjithnjë e më pak kohë në internet. Ndërsa vitet më shtohen mbi supe, asnjë modë kalimtare, s’po më kthehet në gjendje kronike, përkundrazi, tërhiqem gjithnjë e më shumë nga leximi që të kërkon të përfshihesh plotësisht si ai në fëmijëri. Librat kanë ndryshuar, dhe përtvetësimi nuk është

gjithmonë aq i gjithanshëm sa dikur, por mund të gjej akoma, si shënimet e lëna midis faqeve, atë që Birkerts-i e quan “koha e vetes... kohë e thellë, kohaëe gjatë, koha që në thelb na bën të përumbemi plotësisht. “Dhurata e leximit, dhurata e çdo takimi me artin, është se kjo kohë nuk më braktis kur heq sytë nga libri që mbaj në prehër: zgjat, një minutë ose një ditë. “Diçka më shumë se një shkujdesje gjatë bisedës më lejon t’i them një shoku se jam duke lexuar “Ushtari i mirë” i Ford Madox Ford-it, kur po shëtisnim në rrugë së bashku”, shkruan Birkerts-i. “Në një farë mënyre unë po e lexoj romanin ndërsa ec, kur fle, kur kotem apo shkoj me makinë në dyqan për të blerë qumësht”.


Fatkeqësisht, kjo jehonë që vijon është e vërtetë edhe për leximin horizontal. Nëse kaloj një kohë tepër të gjatë para faqeve digjitale, edhe ajo përvojë vijon në orët që pasojnë. Ekranit shfaqet para syve të mi të mbyllur; mendimet e mia përsillen rreth përmbajtjes së ligjëratës: ripodhimit të saktë të saj, dhe hamendësimi të pikëpamjeve të kundërta. Debate të tilla i përfytyroj edhe në dush. “Kur një vepër të detyron të bëhesh njësh me të, shpesh ka fuqinë që të ndjek pas edhe kur je larg saj”, thotë Birkerts-i, dhe sa do të dëshiroja që kjo përumbje të ishte pushtet vetëm i një vepre të madhe. Por nuk është: fantazmat depërtojnë përmes fjalëve në ekran, fantazmat e fjalimeve dhe

çmendurive, e urrejtjes dhe idiotësisë, të sa e sa shkrimeve të dobëta.

“Por mbase kur nevoja është e madhe, e kërkojmë fjalën në faqe dhe veprën që na bën të kthehemi në fushën e forcave të kohës së thellë”, thotë Birkerts-i. “Libri dhe optimizmi im, mund ta merrni me mend, nuk është i palëkundur se do të shihet si strehë, si një mënyrë për t’u shkëputur nga bota në një hapësirë të shenjtëruar nga subjektiviteti”. Është e çuditshme, që edhe në fillim të vitit 2019, optimizmi im është i fortë. Për mua është e qartë se nevoja është mjaft e madhe, po aq e fortë sa ka qenë dhe do të jetë gjithnjë e më e madhe nevoja për kënaqësinë fizike të leximit të diçkaje të mrekullueshme, në një mënyrë që më rrëmben aty për aty duke më treguar në pëllëmbë të dorës atë që më largohej gjatë gjithë kohës.

“Pa jehonën e asaj që lexon, nuk ka dituri”, shkruan Birkerts. “Jehona është një dukuri e natyrshe, hija e domethënies së bashku me trupin e faktit, dhe s’mund të lulëzoj përveçse në kohë të thellë”. Por koha duket veçanërisht e cekët këto ditë, ndërsa vala e një tmerri rrallë kthehet në dallgë sepse gllabërohet nga një tjetër, ndërkohë që një titull tronditës lajmi në mëngjes vjetërohet deri pasdite. Javët kalojnë, dhe miqtë mund t’i shohim vetëm përmes pasqyrave të shtëpisë argëtuese të “Snapchat-i” dhe Instagram-it dhe të ashtuquajturave “tregime” të tyre, të projektuara për t’u zhdukur. Bashkë me të zhduket edhe ideja e të përhershmes: freskojmë dhe rifreskojmë çdo skedë dhe nuk i ke më. Çfarë presim atëherë? Çfarë shpresojmë të gjejmë?

E dimë shumë mirë, e mbajmë mend, edhe nëse në mënyrë të vagullt, atë gjendje të brendshme gjatë leximit që të kënaq më shumë se të shtypësh derisa të lodhesh me gishta në tastierë, kur dihet se ajo që lexojmë në ekran, në një kuptim s’është aty. Sepse, aty në internet, ka një hapësirë të askundit, një kohë të cekët. Sipërfaqja e internetit është e sheshtë dhe e padepërtueshme. Por kur lexon një libër, ne zhytemi, fundosemi, shkrihem me leximin në trup e shpirt. “Mbajmë në duar një mënyrë për ta zvogëluar vrullin e kohërave”, na siguron Birkerts-i. “Mund t’i bëjmë qëndresë prirjes për sipërfaqësoren dhe të rrëmojmë nëpër libra sepse kështu mund të rimarim, qoftë edhe për pak kohë, përgjegjësinë që shmangim rrokjen e së të tërës. Bukuria e përfshirjes në lexime vertikale qëndron tek mungesa e nevojës për të dëshmuar dobinë e vet. Thjesht procesi të përmbush si i tillë”.



JOHAN GUDMUNDSEN-HOLMGREEN, LAESENDE LILLE PIGE, 1900

The Paris Review
Përktheu: Granit Zela
Photo by Marvin Meyer on
Unsplash / exlibris.al

E rrallë

Gruaja gjen unazën e bashkëshortit 47 vjet më pas

Në vitin 1973, një adoleshente Debra McKenna rastësisht la unazën e burrit të saj të ardhshëm në një dyqan në qytetin amerikan të Brunswick Maine. Por rastësia deshi që ajo ta gjente sërish këtë unazë 47 vjet më pas. Ishte një punëtor i cili gjeti në



pyjet e Finlandës metalin e varrosur. McKenna, tashmë 63-vjeçare, unazën e humbi në Portland kur ishte student në shkollën e mesme Morse.

FOTO E DITES



Autobusët duke larguar pasagjerët nga një port në Yokohama afër Tokios. /AP/

E jashtëzakonshme

Brenda qytetit fantazmë në Qipro që dikur ishte shumë i pëlqyer nga të famshmit e pasur

Janë shfaqur imazhet mbresëlënëse të qytetit të braktisur qipriot Maras, që dikur ishte një pikë e nxehtë turistike për të famshmit si Elizabeth Taylor, Richard Burton dhe Brigitte Bardot si dhe të tjerë të famshëm të pasur, që bredhin në plazhet e saj të arta. Vendpushimi mesdhetar, që ndodhet në një periferi jugore të Famagusta, është rrethuar dhe braktisur që kur Turqia push-toi Qipron veriore, pas një grusht shteti të



frymëzuar nga Greqia në vitin 1974. Maras apo Varosha në gjuhën qipriote, ka mbetur e mbyllur dhe e braktisur, pasi Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e miratoi Rezolutën 550, më 11 maj të vitit 1984, për ta ndaluar rivendosjen në qytet. Banorët e kanë braktisur pronën dhe nuk janë kthyer më kurrë, derisa vetëm pak prej tyre janë lejuar ta shohin vendbanimin e dikurshëm, që tani është kthyer në qytet fantazmë.

BARSOLETA E DITËS



Rrëzohet gjakovari prej katit të shtatë, e thërret gruan në telefon dhe i thotë: “Mos bëj bukë se ha në spital”.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Jeni të ndjeshëm dhe pak melankolik sot. Kujtime të vjetra ju sjellin nostalgji për vende të caktuara.</p>	 <p>DEMI Miqtë janë ata që mund t'i vlerësojnë më mirë veprimet tuaja. Mos u mërzisni sot nëse ju kritikojnë në një situatë të caktuar.</p>	 <p>BINJAKËT Edhe pse eprorët tuaj ju vlerësojnë, përsëri nuk ndiheni të kompensuar nga ana materiale. Mbase është koha të kërkonti një rritje rroge.</p>	 <p>GAFORRJA Sot ndiheni shumë mirë sa i përket aspektit të ndjenjave. Diçka e re që sapo ka lindur po ju zë gjithë kohën tuaj dhe mendimet.</p>	 <p>LUANI Sot mund të ndiheni të privilegjuar sa iu përket financave dhe do të shpenzoni për një dhuratë personit të dashur.</p>	 <p>VIrgjëresha Jeni shumë të vendosur t'i shkoni deri në fund një projekti personal. Edhe pse nuk do të keni mbështetje, do t'ia dilni mbanë.</p>
 <p>PESHORJA Megjithëse energjia nuk ju mungon sot do ta ndieni veten të plogësht. Do ta kërkonti qetësinë dhe rehatinë e shtëpisë.</p>	 <p>AKREPI Sot jeni të përqendruar te çështjet e zemrës. Çdo gjë tjetër do të kalojë në plan të dytë për ju.</p>	 <p>SHIGJETARI Keni dëshirë për gjëra të bukura dhe shoqëri të mirë sot. Do t'ju mjaftonte prania e miqve për të qenë rehat me veten.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni gati për të ikur kudo ku mund të shpëtoni nga streset e ditës. Do ta kërkonti shoqërinë e partnerit sot.</p>	 <p>UJORI Sot çdo gjë është fokusuar te financat për ju. Borxhe që do t'ju kthehen dhe shpenzime që nuk i kishit menduar që duhet t'i bëni.</p>	 <p>PESHQIT Edhe pse një pjesë e juaja sot i është përkushtuar karrierës, pjesa tjetër do vetëm qetësi dhe të relaksohet. Jeni në dyluftim me veten.</p>

Jennifer Lopezi i futet industrisë së modës, sjell koleksion të këpucëve dhe çantave



Jennifer Lopezi po e çimenton vendin e saj edhe në industrinë e modës. Camuto Group ka njoftuar se ka lëshuar koleksionin e Jennifer Lopezit me këpucë dhe çanta të krijuara në bashkëpunim me artistë të shumë përkushtuar.

Linja e parë me këpucë do të debutojë në pranverë 2020 dhe për t'u pasuar me çanta dore. Artikujt do të jenë në dispozicion ekskluzivisht në dyqanet e Designer Shoe Warehouse dhe në DSW.com.

Enrique Iglesias bëhet baba i një vajze



Këngëtari i njohur latin Enrique Iglesias është bërë baba për herë të tretë. Ai bashkë me gruan e tij Anna Kournikova u bënë prindër të një vajze më 30 janar të këtij viti. Këtë e bëri me dije këngë-

tari me anë të një fotografie në rrjetin social "Instagram", në të cilën i kishte vendosur mbishkrimin "Dielli im". Enrique dhe Anna janë prindër të binjakëve dyvjeçar, Nicholas dhe Lucy.



Pas dy vjetësh romancë me sauditin miliarder, Rihanna e vetme në këtë Shën Valentin

Rihanna nuk ka qenë beqare në ditën e Shën Valentinit për dy vjet radhazi, këtë herë edhe pse po, ky nuk është shqetësimi i saj, sepse këngëtarja do ta kalojë ditën duke vazhduar rritjen e perandorisë së saj shumëmilionëshe. Rihanna nuk ka "Love on the Brain" këtë Shën Valentin. 31-vjeçarja që u

nda nga miliarderi sauditi, Hassan Jammal, është duke e kaluar ditën sikurse të tjerët. "Rihanna është plotësisht e lumtur që bën gjërat e saj të përditshme në Ditën e Shën Valentinit këtë vit dhe është vërtet si çdo ditë tjetër për të", ka pohuar një burim për "Hollywood Life".

Justin Bieber tregon se si e kalon kohën me gruan e tij kur nuk ka koncerte



Justin Bieberi duket se ka vendosur t'u tregojë fansave disa gjëra shumë intime, siç është seksi me gruan e tij Hailey Baldwin. Ai ka dhënë një përgjigje interesante kur është pyetur se çfarë bën kur ka kohë të lirë dhe kur nuk ka koncerte ose aktivitete të tjera. "Kur unë jam me

gruan time, ne kemi qejf të bëjmë... besoj se ju e dini se çfarë bëjmë ne. Ndonjëherë seksi bëhet i çmendur. Pak a shumë kjo është ajo çfarë ne bëjmë në kohë të lirë. Ne kemi dëshirë të shohim filma bashkë, por definitivisht më shumë na pëlqen të relaksohemi", ka thënë 25-vjeçari.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' me optimizëm fillojnë misionin e kualifikimit

Trajneri Christos Marmarinos dhe basketbollistët Drilon Hajrizi e Erjon Kastrati janë optimistë se Përfaqësuesja e Kosovës mund të dalë e suksesshme në dy ndeshjet para-kualifikuese për Kampionatin Botëror 2023 kundër Islandës dhe Luksemburgut



PRISHTINË, 17 SHKURT - Basketbollistët e Kosovës ditën e Pavarësisë e kanë festuar duke u përgatitur maksimalisht për dy ndeshjet parakualifikuese për Kampionatin Botëror 2023. Ashtu siç ishte paraparë, përgatitjet filluan të hënën nga ora 10:00 dhe do të vazhdojnë edhe në ditët e ardhshme, derisa ndeshja e parë e Kosovës është ndaj Islandës më 20 shkurt në Prishtinë, kurse më 23 shkurt, "Dardanët" janë mysafirë të Luksemburgut. Atmosfera në ekipin e Kosovës ishte shumë e mirë dhe lojtarët do të japin 100 % nga vetja, si në stërvitje, ashtu edhe në parket për Kosovën. Stërvitja e së

hënës ishte e para për përzgjedhësin e ri të Kosovës, Christos Marmarinos. "Kemi filluar mirë stërvitjet dhe do të mundohemi të përgatitemi sa më mirë, pasi nuk kemi shumë kohë. Synimet janë të fitojmë. Atmosfera në ekip është shumë e mirë. 17 Shkurti është ditë e rëndësishme për Kosovën. Është e rëndësishme që lojtarët që bartin fanellën e Kosovës të përfaqësojnë sa më mirë shtetin në garat ndërkombëtare", deklaroi përzgjedhësi i Kosovës pas stërvitjes së parë. Optimist në stërvitjen e parë ishte edhe Drilon Hajrizi. "Hymë në këtë stërvitje pas angazhimeve me skuadrat gjatë

Final 8. Besoj se do të angazhohemi maksimalisht. Kemi një ekip të mirë për të pasur sukses. Me punën që do të bëjmë shpresoj shumë se do të tregojmë lojërë të mira", u shpreh Hajrizi.

Basketbollisti Erjon Kastrati foli gjithashtu pas stërvitjes së parë. "Fillimisht dua të them se kam nderin dhe kënaqësinë që jam i ftuar në Kombëtaren e Kosovës. Stërvitja e parë ishte për t'u njohur më shumë se si do të luajmë

dhe në stërvitjet e ardhshme besoj se do të rritet intensiteti. Siç ka thënë trajneri duhet të mundohemi të fitojmë në çdo ndeshje. Do të japim më të mirën nga vetja jonë në këto ndeshje", ka theksuar Kastrati.

Osmani: Sportistët e kanë skalitur emrin e Kosovës në qindra piedestale

PRISHTINË, 17 SHKURT - Mysafirë në seancën solemne të 12-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës ishin trajneri Driton Kuka dhe dy xhudistet, Majlinda Kelmendi dhe Distria Krasniqi. Në fjalimin e kryetares së Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, një vend të veçantë kanë pasur edhe sportistët e vendit. "Sot Kosova jonë jo vetëm frymon e lirë, por është vend që po e krijon imazhin e ri, duke i ofruar botës vlera të shquara në arte, në kulturë, në sport e në fusha të tjera. Xhudistet Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, bashkë me trajnerin e tyre, Toni Kukën, e kanë skalitur emrin e Kosovës në qindra piedestale, deri në



olimpiadën e Brazilit, duke e lartësuar flamurin e Kosovës aty ku nuk ishte e mundur më

herët", ka thënë Osmani. "Ata na kanë bërë të qajmë nga gëzimi e të buzëqeshim nga lumturia. Ju

lus që me duartrokite t'ua kthejmë nderin që ato ia kanë bërë shtetit të tyre. Krahas tyre, djel-

moshat e kombëtares së Kosovës i kanë ngrohur zemrat tona, por e kanë forcuar edhe identitetin tonë në botë. U duartrokasim fort nga ky tempull dhe i ftojme të qëndrojnë fort pas nderit që ua jep flamuri i shtetit të tyre", ka deklaruar kryetarja Osmani. Ndërsa trajneri i xhudos, Driton Kuka, nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka thënë se vendit i duhet më shumë unitet politik. "Urime Pavarësi! 12 vjet shtet drejtpërdrejt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kosovës i duhet unitet politik më shumë se kurrë për të mirën e vendit! Kosova mbi të gjitha...", ka shkruar Kuka. Edhe sportistët e tjerë kanë uruar për 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

Rrahmani: Besojmë se mund të kualifikohemi në 'Euro 2020'

PRISHTINË, 17 SHKURT - Amir Rrahmani beson se Përfaqësuesja e Kosovës në futboll mund të kualifikohet në Kampionatin Evropian. Në fund të muajit mars Kosova do të përballlet me Maqedoninë, ku do ta kërko-

jë fillimisht finalen në "play-off" të Nations League dhe më pas kualifikimin në "Euro 2020". Kapiteni i 'Dardanëve', Amir Rrahmani, në një intervistë për "Super Sport", tha se të gjithë te Kosova besojnë se

mund ta bëjnë ëndrrën realitet. "Besojmë që mund të arrijmë të kualifikohemi në 'Euro 2020'. Kemi kundërshtar të fortë, por të gjithë besojmë. Duam të gjithë të kemi paraqitje më shumë të jemi të gatshëm për ato

ndeshje. Si kjo mundësi kemi pak në karrierën tonë si futbollistë andaj shpresojmë që të arrijmë atje. Maqedonia ka futbollistë që luajnë në ekipe të mëdha, nuk janë të dobët, kanë sulm të rrezikshëm", ka thënë Rrahmani.



Kastrati bën hapin e madh në karrierë, prezantohet te Dinamo Zagrebi

ZAGREB, 17 SHKURT - Reprerentuesi i Kosovës, Lirim Kastrati, ka hedhur një hap të rëndësishëm në karrierën e tij. Ai është zyrtarizimi si lojtari më i ri i Dinamos së Zagrebit.

Bëhet fjalë për një kontratë 5-vjeçare, e cila tregon qartë besimin e klubit të ri karshi Kastratit. Sa i përket shifrës së derdhur në arkat e klubit të Lokomotivës së Zagrebit,

bëhet fjalë për pak më tepër se 2.5 milionë euro. Ai do të lihet deri në fundin e sezonit te Lokomotiva, për t'u bashkuar më pas me Dinamon. Kastrati ka qenë pjesë e Shkëndijës së

Tiranës, që njihet si Shkolla e Mjeshtërisë Sportive. Atje ka dalë edhe kampioni i Shqipërisë me U-17, ndërsa më pas do t'u bashkohej të rinjve të Lokomotivës.



Atletico, testi i parë serioz për Liverpoolin. Dortmundi sfidon PSG-në

MADRID, 17 SHKURT (ER) - Gara më e fortë në futboll, Liga e Kampioneve, rikthehet sonte (e martë) me dy superndeshje. Kampioni i Evropës, Liverpooli, është mysafir i Atletico Madridit në "Wanda Metropolitano", aty ku u kurorëzuan me titullin e më të mirit në vitin e kaluar. Kjo përballje vlerësohet e jashtëzakonshme për ta parë se a është e gatshme skuadra nga Madridi për ta ndalur rrugëtimin e Liverpoolit drejt finales së tretë radhazi, apo Jurgen Klopp do ta vazhdojë shkëlqimin edhe në këtë garë sikurse në edicionin e kaluar dhe në Premierë Ligë këtë edicion. Atletico arriti në mesin e 16 skuadrave më të mira si e dyta e Grupit D pas Juventusit, por mbi Bayer Leverkusenin dhe Lokomotiv Moskën. Në La Liga skuadra e Diego Simeones nuk është në formën më të mirë pasi ka 12 pikë më pak se Real Madridi. Një tjetër lajm i keq për klubin spanjoll është se shtatë lojtarë rezikojnë të mungojnë në ndeshjen e së martës ndaj "Reds".

Në anën tjetër, Liverpooli nuk ka lëndime dhe është afër titullit të kampionit në Angli, prandaj do të luajë më lirshëm në Ligën e



Kampionëve. Fazën e grupeve Liverpooli e mbylli në vendin e parë të Grupit E me 13 pikë. Në ndeshjen tjetër Borussia Dortmund do ta presë Paris Saint-Germain në Gjermani. Kjo do të jetë përballja e tretë në mes të këtyre dy klubeve, kurse dy ndeshjet e para në kuadër të fazës së grupeve në edicionin 2010-11 kishin përfunduar baras. Dortmundi grumbulloi 10 pikë në gjashtë ndeshjet e tyre të Grupit F këtë sezon për të përfunduar në vendin e dytë pas Barcelonës. Nuk do të jetë aspak lehtë për skuadrën e Lucien Favre që t'i eliminojë francezët e PSG-së, por ata në këtë ndeshje hyjnë pas fitores që e arritën të premtën kundër Eintracht Frankfurtit (4-0). Jadon Sancho ishte përsëri në rezultatin për gi-

gantët gjermanë, ndërsa sulmuesi adoleshent Erling Braut Haaland ka qenë në formë mahnitëse që nga arritja në janar, duke shënuar nëntë herë në gjashtë paraqitje për klubin e tij të ri. PSG-ja të shtunën luajti baras 4-4 me nga Amiens në Ligën 1, por 13 pikë larg vendit të dytë. Liga e Kampioneve është gara që kjo skuadër synon ta fitojë në këtë edicion dhe në fazën e grupeve kanë qenë mbresëlënëse paraqitjet e tyre, duke e mbyllur në vend të parë me pesë pikë para Realit. Gjermanët në këtë ndeshje kanë mungesë Marco Reus dhe Thomas Delaney, derisa në dyshim është Julian Brandt. Colin Dagba dhe Abdou Diallo nuk janë të gatshëm për francezët, kurse në dyshim është Kimpembe.

SHKURT

Guardiola, besnik i Cityt

"ESPN" dhe "The Times" raportojnë se trajneri Pep Guardiola u ka komunikuar drejtuesve të Manchester Cityt se nuk ka ndërmend të largohet, me apo pa Ligën e Kampioneve. Pep është i bindur se dënimi i dhënë nga UEFA për shkelje të rregullave të "Fair Play financiar" do të shfuqizohet, edhe nëse kjo nuk ndodhë, ua ka bërë të qartë drejtuesve dhe lojtarëve se ka ndërmend ta respektojë kontratën e cila i skadon më 2021. Si një kapiten i vërtetë, Pep nuk dëshiron ta braktisë anijen, e sheh si një mungesë respekti, për të ardhmen ka ende kohë.

Silva në fund të sezonit largohet nga PSG-ja

E ardhmja e Thiago Silva duket se do të jetë larg Paris Saint Germanin. Mesa duket palët nuk kanë arritur ta gjejnë marrëveshjen për rinovimin e kontratës së brazilianit, që skadon në qershor. Sipas mediave franceze, agjenti i 35-vjeçarit u ka kërkuar francezëve rinovimin për dy vjet, por klubi nga Parc des Princes nuk ka pranuar. Drejtori sportiv, Leonardo, deklaroi se Thiago Silva duhet ta mbyllë me sukses aventurën e tij tetëvjeçare me francezët për t'ua lënë vendin talentëve të rinj. Kështu klubi i ka ofruar një kontratë prej profesionisti 17-vjeçarit Tanguy Kouassi, gjithashtu një nga objektivat e Parisit për markaton e verës është Koulibaly i Napolit. Pavarësisht prej situatës së krijuar, Thiago Silva mund të rikthehet te Milani, ekip ku ka luajtur në vitet 2009-2012.

Puyol: Messi mund të luajë deri në moshën 38-vjeçare

Ish-mbrojtësi i Barcelonës, Carles Puyol, ka thënë se Leo Messi mund të luajë deri në moshën 38-vjeçare, pasi e ka potencialin për ta bërë këtë gjë. Argentinasi gjatë këtij sezoni ka realizuar 14 gola dhe 12 asistime në La Liga, çka po e dëshmon se vitet për të momentalisht janë vetëm numër. "Messi është 32-vjeçar dhe një lojtar që kujdeset aq shumë për veten sa mund të luajë deri në moshën 38-vjeçare", u shpreh ish-reprerentuesi i Spanjës. "Pse duhet ta mendojmë Barçën pa Messin kur ai është ende aty. Ne duhet të fitojmë sa më shumë përderisa e kemi atë në skuadër", ka shtuar Puyol.

Chelsea synon transferimin e Sanchos

Chelsea po synon transferimin e yllit të Borussia Dortmundit, Jadon Sancho. Siç raporton "Sky Sport", klubi anglez ka shtuar kontaktet për t'i bindur drejtuesit e Dortmundit, por edhe lojtarin. 19-vjeçari po bën një sezon të shkëlqyer, pasi në 30 ndeshje në të gjitha kompeticionet, ka shënuar 16 gola dhe ka dhuruar 17 asistime.

Conte: Interi ia dhuroi golat Lazios

Antonio Conte ka thënë se Interi ia ka dhuruar Lazios golat e shënuara në humbje 2-1 në kuadër të javës së 24-t në Serinë A. Pas kësaj fitore, Lazio e ka rrëmbyer vendin e dytë në Serinë A me vetëm një pikë dallim nga skuadra lidere, Juventus. "Mendoj se ishte një paraqitje e mirë edhe pse rezultati nuk na pëlqeu dhe si i pranuar golat, ne i dhuruam ato te Lazio. Nuk ishim mjaftueshëm të koncentruar, nuk u kushtuam rëndësi detajeve dhe ata përfituan nga gabimet tona", ka thënë Conte. "Ishim shumë të butë në ndërhyrjet tona dhe pësuar dy golat nga këto gjëra. E njëjta gjë na kishte ndodhur edhe ndaj Barcelonës e Borussia Dortmundit. I lëshuam pikët nga dora", ka shtuar Conte.

LeBron fiton 'All Star Game 2020', Leonard zgjidhet MVP

LOS ANXHELOS, 17 SHKURT - Skuadra e LeBron Jamesit fitoi ndeshjen e madhe të yjeve të NBA-së, "All Star Game 2020", zhvilluar në Chicago, duke mundur 157-155 skuadrën e Giannis Antetokounmpo. Një ndeshje e veçantë, të cilën NBA ia dedikoi yllit të saj, Kobe Bryant, i ndarë nga jeta tri javë më parë pas një aksidenti ajror. Kawhi Leonard, që luante me skuadrën fituese, u shpall MVP i kësaj ndeshje, duke realizuar 30 pikë. Një ndeshje që ashtu si gjithnjë, ishte një spektakël në fushë, me basketbollistët më të mirë në botë që shkëlqyen në parket. Format i ri i aplikuar nga organizatorët, ku perioda e katërt dhe e fundit nuk kishte



kronometër, ishte mjaft argëtues. Kjo e bëri të hapur ndeshjen, por skuadra e

LeBron arriti të shkëlqejë në fundin e takimit, duke e merituar fitoren.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkurseve, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" S.A vendosi që me datë 17.02.2020 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

3(tre) Punëtor Fizik - Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë shkollën fillore ose së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj letërnjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj)

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 18.02.2020 deri më datën 03.03.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave /
Ministry of Internal Affairs and Public Administration



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Në pajtim me Ligjin e punës Nr. 03/L-212 kreu II, neni 8, Ligjin për Policinë Nr. 04/L-076, kreu V, Neni 44 i këtij ligji, Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, Kreu III, Neni 5, paragrafi 2/2, Policia e Kosovës:

U skladu sa Zakonom Rada Br. 03/L-212 poglavlje II, član 8, Zakona o Policiji Br. 04/L-076, poglavlje V, Član 44 ovog Zakona, Administrativnim Uputstvom 02/2018 o radnom odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 5, stav 2/2, Policija Kosova:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Referenca: 07/1-01SAP-R /13/20

Policia e Kosoves vazhdon afatin e konkursit edhe për shtatë (7) ditë për pozitën:

1. Teknik medicinal (katër vende të lira pune)

Ky konkurs vazhdohet nga data **18.02.2020** deri me **24.02.2020** për shkak të mosarritjes të një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik.

Për çdo informacion mund të kontaktoni Sektorin e Rekrutimit dhe Seleksionimit, nr. tel. 038 245184

PRODUZUJE ROK KONKURSA

Referencija: 07/1-01SAP-R /13/20

Policija Kosova prodhuje rok konkursa za još sedam (7) dana za položaj:

1. Medicinski tehničar (çetiri slobodna radna mesta)

Ovaj konkurs se prodhuje od **18.02.2020** do **24.02.2020** zato što nije postignut balansiran broj aplikacija na etničkom aspektu.

Za svaku informaciju možete kontaktirati Sektor Rekrutacije i Selekcije na broj tel. 038 245184



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 17.02.2020 të shpallë:

**KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendeve të punës:**

3 (tre) Vozitësa të kategorisë " C " - Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij.
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispeçeri.
- Vendos (monton) letren e re të tahograftit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve.
- Vozitësi i cili e monton letren e tahograftit ka obligim që në të të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare.
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjete e nevojshme të punës (lopata, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon.largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresen e punës.
- Në rast nevojë ndron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomsterin,
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes
- Çdo sjellje të pandërgjegjeshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejtë
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim.
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi.
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj letërnjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. Mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 18.02.2020 deri më datën 03.03.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj kujdestare
për vajzën 7 muajshe
në Prishtinë.
Për informata në tel:
044-444-009**

► Zymer Ferizi shpall të pavlefshme dëftesën e SHF "Emin Duraku" Likovc.

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.**



Gjej PUNË


- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite



*Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Prishtina"
sh.a. ua uron 12 vjetorin e shpalljes së
Pavarësisë së Republikës së Kosovës*

